



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.136**

**13 tetor**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 316 datë 16.9.2010	Për disa shtesa në ligjin nr. 7764, datë 2.11.1993 “Për investimet e huaja” ..... 7435
Ligj nr.10 323 datë 23.9.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar ..... 7438
Ligj nr.10 324 datë 23.9.2010	Për disa shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar ..... 7439
Ligj nr.10 325 datë 23.9.2010	Për bazat e të dhënave shtetërore ..... 7440
Vendim i KM nr.752, datë 8.9.2010	Për miratimin e “Standardeve të shërbimit të kujdestarisë për fëmijët në nevojë” ..... 7443
Vendim i KM nr.759, datë 15.9.2010	Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve e të studentëve, në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2010-2011 7463
Kërkesë e METE nr.2727/6, datë 29.9.2010	Për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe kulturave bujqësore, që preken nga ndërtimi i centralit elektrik me erë (parqe eolike)..... 7469

**LIGJ**  
**Nr.10 316, datë 16.9.2010**

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 7764, DATË 2.11.1993 “PËR INVESTIMET E HUAJA”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7764, datë 2.11.1993 “Për investimet e huaja”, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në fund të termit “investitor i huaj”, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) çdo “shoqëri komunitare”, në kuptimin e nenit 49 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, miratuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare””.

2. Në fund të nenit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Mbrojtje e posaçme shtetërore” nënkuptohet mbrojtja juridike civile që Republika e Shqipërisë, me vendim të Këshillit të Ministrave, u jep investimeve të huaja, në përputhje me kushtet dhe rrethanat e përcaktuara në këtë ligj, në rastet kur, për shkak të konflikteve gjyqësore me palë të treta private, pengohet gjyqësisht realizimi i investimit të huaj ose ushtrimi i veprimtarisë ekonomike, që buron apo lidhet me të.”.

Neni 2

Pas nenit 8 shtohen nenet 8/a, 8/b, 8/c, 8/ç, 8/d dhe 8/dh me këtë përmbajtje:

“Neni 8/a

**Kushtet për dhënien e mbrojtjes së posaçme shtetërore**

Këshilli i Ministrave mund t’i japë investimit të huaj mbrojtje të posaçme shtetërore, në rastet kur ky investim kryhet në infrastrukturë publike ose turistike, energjetikë apo bujqësi:

a) në bazë të një kontrate koncesioni shtetëror, në kuptimin e ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar;

b) mbi një pasuri të paluajtshme, të vënë në dispozicion të investitorit të huaj nga shteti shqiptar;

c) mbi një pasuri të paluajtshme, mbi të cilën investitori i huaj i ka fituar të drejtat, në bazë të dokumenteve apo të akteve publike të rregullta, të vlefshme dhe të ligjshme, të lëshuara nga një organ kompetent shtetëror apo ent publik, si dhe kryen apo parashikon të kryejë një investim për një vlerë jo më pak se 10 milionë euro.

Neni 8/b

**Përmbajtja e mbrojtjes së posaçme shtetërore**

1. Mbrojtja e posaçme shtetërore parashikon zëvendësimin me të drejta të plota të investitorit të huaj nga ana e shtetit shqiptar në konfliktin juridiko-civil me palë të treta private. Zëvendësimi i investitorit të huaj si palë bëhet në bazë të nenit 200 të Kodit të Procedurës Civile.

2. Përfaqësimi i shtetit në gjykim bëhet nga ministria, që mbulon fushën me të cilën lidhet investimi i huaj, nëpërmjet Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, në përputhje me rregullat dhe procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”.

3. Mbrojtja e posaçme shtetërore jepet vetëm pasi ka lindur mosmarrëveshja juridike civile me palët e treta private dhe asnjëherë *a priori*. Mbrojtja e posaçme shtetërore jepet vetëm për mosmarrëveshje individualisht të përcaktuara dhe përfundon me zgjidhjen me mirëkuptim ose gjyqësisht të këtyre mosmarrëveshjeve ose, sipas rastit, me ekzekutimin e vendimit të gjykatës.

4. Mbrojtja e posaçme shtetërore mund të përfshijë edhe marrjen përsipër nga ana e shtetit të detyrimeve të vendosura nga gjykata shqiptare mbi investitorin e huaj, në dobi të palëve të treta private, me kusht që:

a) kjo mbrojtje të jetë vendosur dhe shteti shqiptar të ketë qenë i përfaqësuar në gjykatë, së paku, përpara fazës së mbylljes së hetimit gjyqësor;

b) vendimi i Këshillit të Ministrave për dhënien e kësaj mbrojtjeje të ketë parashikuar, shprehimisht, marrjen përsipër nga ana e shtetit shqiptar të çdo detyrimi që gjykata shqiptare mund të vendosë në çështjen konkrete ndaj investitorit të huaj.

#### Neni 8/c

### **Procedura për dhënien e mbrojtjes së posaçme shtetërore**

1. Mbrojtja e posaçme shtetërore jepet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrisë që mbulon fushën me të cilën lidhet investimi, në bazë të kërkesës me shkrim, të argumentuar dhe të shoqëruar me dokumentacion provues, që investitori i huaj depoziton pranë ministrisë që mbulon fushën. Mbrojtja e posaçme shtetërore nuk përbën të drejtë ligjore të investitorit të huaj. Dhënia ose refuzimi i saj është në diskrecionin e Këshillit të Ministrave.

2. Ministri, që mbulon fushën, paraqet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave nismën, në formën e një projektvendimi individual, për dhënien e mbrojtjes së posaçme shtetërore, sipas procedurës së përcaktuar nga ligji nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. Në relacionin shoqërues të projektvendimit ministri duhet të argumentojë plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 8/a dhe interesin publik për dhënien e mbrojtjes së posaçme shtetërore. Relacioni duhet të shoqërohet, në çdo rast, me analizën juridike të mosmarrëveshjes, të kryer nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

Ky dokument i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ka për të tretët të njëjtin status konfidencial, si debatet, mendimet e ministrave, të pasqyruara në procesverbalin e mbledhjes së Këshillit të Ministrave dhe përdoret vetëm nga anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjatë shqyrtimit dhe miratimit.

3. Në rastet kur projektvendimi parashikon marrjen përsipër të detyrimeve, sipas pikës 4 të nenit 8/b të këtij ligji, projektvendimit i bashkëlidhet edhe qëndrimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore për kërkesën në fjalë, sipas ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

4. Vendimi për dhënien e mbrojtjes së posaçme shtetërore njoftohet publikisht, në përputhje me rregullat në fuqi për publikimin e akteve të Këshillit të Ministrave, kurse projektvendimi dhe mosmiratimi i mbrojtjes së posaçme shtetërore nuk njoftohen publikisht. Në rast mosmiratimi, praktika arkivohet.

#### Neni 8/ç

### **Afati për shqyrtimin dhe dhënien e mbrojtjes së posaçme shtetërore**

1. Afati për shqyrtimin dhe dhënien e mbrojtjes së posaçme shtetërore është 45 ditë nga data e marrjes së kërkesës, së bashku me dokumentacionin shoqërues nga ana e investitorit të huaj. Projektvendimi për propozimin për dhënien e mbrojtjes së posaçme shtetërore dhe dokumentacioni shoqërues i paraqiten Këshillit të Ministrave brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, së bashku me dokumentacionin shoqërues.

2. Në rast se, me kalimin e afatit 30-ditor ministria, që mbulon fushën, nuk e çmon të justifikueshme ligjërisht dhe nga pikëpamja e interesit publik paraqitjen e propozimit për dhënien e mbrojtjes së posaçme shtetërore, atëherë ajo arkivon kërkesën së bashku me arsyetimin ligjor të rastit, si dhe njofton investitorin e huaj, pa dhënë shpjegime për mosmarrjen e nismës.

3. Mosmiratimi nga Këshilli i Ministrave i propozimit për dhënien e mbrojtjes së posaçme shtetërore nuk i njoftohet as kërkuetit, as palëve të treta.

4. Me kalimin e afatit 45-ditor, kërkueti duhet ta quajë kërkesën të rrëzuar.

Neni 8/d

#### **Masa të veçanta në kuadër të mbrojtjes së posaçme shtetërore**

1. Pas dhënies së mbrojtjes së posaçme shtetërore sigurimi i padisë mund të bëhet vetëm mbi pasuri ose të ardhura publike. Në rast se këto masa janë vendosur më parë, atëherë gjykata pranon kërkesën e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për zëvendësimin e masave për sigurimin e padisë me masa të tjera mbi pasuri apo të ardhura publike, në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 206 të Kodit të Procedurës Civile.

2. Në rast se gjykata, me vendim të formës së prerë, ka rrëzuar të drejtat e investitorit të huaj mbi pasuritë e paluajtshme, objekt i investimit të huaj, dhe ia ka njohur këto të drejta palëve të treta private, atëherë Këshilli i Ministrave mund të vendosë shpronësimin, për interes publik, të palëve të treta private, si dhe t'ia kalojë pasuritë investitorit të huaj, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 8/dh

#### **Mbulimi i shpenzimeve nga mbrojtja e posaçme shtetërore**

1. Të gjitha shpenzimet e përfaqësimit, për shkak të zëvendësimit të palës, si rezultat të mbrojtjes së posaçme shtetërore, mbulohen nga investitori i huaj, që kërkon mbrojtjen. Kur gjykata vendos që këto shpenzime të kalojnë në ngarkim të palëve të treta ndërgjyqëse, atëherë investitori i huaj kompensohet në masën e vendosur nga gjykata.

2. Ministri i Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrin e Financave, përcaktojnë me udhëzim të përbashkët shpenzimet e përfaqësimit dhe rregullat për shlyerjen e detyrimit.

3. Në rastet kur vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton marrjen përsipër nga ana e shtetit të detyrimeve të vendosura nga gjykata shqiptare, atëherë këto detyrime përballohen nga Buxheti i Shtetit. Kjo dispozitë nuk shuan të drejtën e organeve shtetërore, për të kërkuar kompensim në rrugë gjyqësore ndaj çdo pale të tretë për dëmin e shkaktuar nga zbatimi i vendimit gjyqësor.”.

Neni 3

#### **Dispozitë kalimtare**

Mbrojtja e posaçme shtetërore, në kuptimin e këtij ligji, do të jepet deri më 31 dhjetor 2014.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6703, datë 6.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 323, datë 23.9.2010**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9780, DATË 16.7.2007 “PËR  
INSPEKTIMIN E NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 5 bëhen këto shtesa:

- a) Në shkronjën “e”, pas fjalëve “jep informacionin e kërkuar Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar” shtohen fjalët “brenda një afati kalendarik 10-ditor”.
- b) Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:  
“ë) merr vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës, për shpenzimet e prishjes së objektit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme.”.

**Neni 2**

Në nenin 9, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) kontrollon, me kërkesë të inspektoratit të mjedisit, përmbushjen e kërkesave ligjore për shfrytëzimin e karrierve të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit dhe për pusët e ujit.”.

**Neni 3**

Në nenin 10/1 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ushtrimi i përgjegjësisë, sipas pikës 1 të këtij neni, kryhet vetëm kur në kantierin, objekt inspektimi, nuk ka filluar apo nuk është në proces një inspektim nga inspektorati vendor, si dhe kur vërtetohet një nga rrethanat e mëposhtme:

- a) ushtrimi i përgjegjësive kërkohet nga vetë inspektorati ndërtimor e urbanistik vendor i komunës/bashkisë ose nga kryetari i komunës apo bashkisë përkatëse, për shkak të pamundësisë financiare për ushtrimin e kësaj përgjegjësie nga inspektorati vendor;
- b) inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut nuk e ka inspektuar këtë territor më parë ose nuk është shprehur me vendim për këtë ndërtim, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj;
- c) vendimi i inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar brenda afatit ligjor të caktuar në këtë ligj.

Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, gjatë ushtrimit të kësaj detyre, për të provuar kundërligjshmërinë e ndërtimit, sipas rastit, kërkon dokumentacion të plotë nga zyra e urbanistikës pranë komunës/bashkisë/qarkut. Zyra e urbanistikës pranë komunës/bashkisë/qarkut, brenda 15 ditëve, i paraqet INUK-së, dokumentacionin e plotë ligjor, që vërteton kundërligjshmërinë e ndërtimit. Nëse zyra e urbanistikës pranë komunës/bashkisë/qarkut nuk kthen përgjigje brenda afatit 15-ditor, INUK-ja kryen inspektim në kantier, objekt inspektimi, për të verifikuar ligjshmërinë e ndërtimit.

Në rast se pas inspektimit, INUK-ja konstaton se ndërtimi është i kundërligjshëm, vepron sipas nenit 13 të këtij ligji.

Gjatë ushtrimit të kësaj detyre, Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar ka përgjegjësinë të bëjë kallëzim penal për veprën penale të konstatuar dhe të paraqesë kërkesë për heqje licence, nëse punimet kryhen nga subjekte të pajisura me leje dhe licencë.”.

#### Neni 4

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Mosrespektimi i afatit për dhënien e informacionit dhe pengimi në përmbushjen e detyrave, në masën 100 000 lekë.”.

b) pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Mosparaqitja e kërkesës për heqje licence të mbikëqyrësit të punimeve, pranë organeve kompetente, në masën 50 000 lekë.”.

#### Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6707, datë 6.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

### LIGJ

**Nr.10 324, datë 23.9.2010**

### **PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 8402, DATË 10.9.1998 “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### VENDOSI:

Në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

#### Neni 1

Në nenin 7, në vijim të paragrafit të tretë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut.”.

#### Neni 2

Në nenin 9 bëhen këto shtesa:

a) Në paragrafin e parë, pas fjalëve “inspektoratin ndërtimor e urbanistik, në nivel bashkie/komune/qarku”, shtohen fjalët “dhe INUK-ja, kur kërkohet nga kjo e fundit, për zonat me rëndësi kombëtare.”.

b) Në fund të paragrafit të dytë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut, brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të dosjes, duhet të pajisë subjektin me vërtetim për plotësimin ose jo të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur. Në përfundim të afatit 5-ditor, nëse inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut nuk shprehet, atëherë dokumentacioni tekniko-ligjor, i paraqitur nga subjekti, konsiderohet si i pranuar i plotë nga inspektorati i sipërpërmendur.”.

### Neni 3

Në fund të nenit 15 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për moszbatimin e detyrimeve, të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, përveç dënimit me gjobë, brenda 10 ditëve nga çasti i konstatimit të shkeljes, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut u paraqet organeve përkatëse kërkesën për heqjen e licencës së mbikëqyrësit të punimeve.”.

### Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6708, datë 6.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

## LIGJ

**Nr.10 325, datë 23.9.2010**

### **PËR BAZAT E TË DHËNAVE SHTETËRORE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

#### KREU I DISPOZITA TË PËRGJTHSHME

Neni 1

#### **Qëllimi**

Ky ligj përcakton rregullat bazë për krijimin, administrimin e bazave të të dhënave shtetërore dhe ndërveprimin ndërmjet tyre, për të siguruar përdorimin me efektivitet, për interesa dhe shërbime publike, nga çdo subjekt i interesuar.

Neni 2

#### **Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për bazat e të dhënave shtetërore, që:

- a) krijohen dhe administrohen nga çdo institucion publik;
- b) krijohen ose administrohen nga çdo person juridik privat, që ushtron funksion publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Bazat e të dhënave shtetërore, që krijohen për të plotësuar vetëm kërkesat për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të institucionit publik, nuk i nënshtrohen këtij ligji.

### Neni 3 **Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Baza e të dhënave shtetërore” kuptohet grumbullimi i organizuar i informacionit, i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhen nëpërmjet një sistemi kompjuterik, si pjesë e plotësimit të detyrimeve ligjore të institucionit administrues.

b) “Subjekt i interesuar” kuptohet çdo person fizik ose juridik, të cilit i lejohet të aksesojë bazën e të dhënave shtetërore.

c) “Dhënësi i informacionit” kuptohet një person publik apo privat, i përcaktuar në aktin e krijimit, për të dhënë informacionin në bazën e të dhënave shtetërore.

ç) “Institucioni administrues” kuptohet institucioni përgjegjës për administrimin e bazës së të dhënave shtetërore, në përputhje me aktin e krijimit.

d) “Ndërveprimi” kuptohet procesi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet bazave të të dhënave.

dh) “Përfundimi i funksionimit” kuptohet shkatërrimi, transferimi në një bazë tjetër të dhënash shtetërore, arkivimi, përdorimi për qëllime statistikore dhe shkencore, i plotë ose i pjesshëm, i bazës së të dhënave.

## KREU II RREGULLAT PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE

### Neni 4 **Krijimi i bazës së të dhënave shtetërore**

1. Baza e të dhënave shtetërore krijohet me ligj ose me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Akti i krijimit të bazës së të dhënave shtetërore përcakton:

a) institucionin administrues të bazës së të dhënave shtetërore;

b) të dhënat parësore dhe dytësore;

c) dhënësin/dhënësit e informacionit;

ç) ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave;

d) nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara.

3. Ndalohet krijimi i bazave të të dhënave shtetërore të veçanta për të njëjtin informacion ose qëllim.

### Neni 5 **Administrimi i bazës së të dhënave shtetërore**

Administrimi i bazës së të dhënave shtetërore bëhet në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi. Rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas nenit 10 të këtij ligji.

### Neni 6 **Përfundimi i bazës së të dhënave shtetërore**

Përfundimi i funksionimit të bazës së të dhënave shtetërore bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e nxjerra në zbatim të nenit 10 të këtij ligji.



#### Neni 7

### **Të dhënat parësore dhe dytësore**

Baza e të dhënave shtetërore përmban të dhënat parësore dhe të dhënat dytësore.

- a) Të dhënat parësore të një baze të dhënash shtetërore janë informacione specifike, të mbledhura nga institucioni administrues, në përputhje me aktin e krijimit.
- b) Të dhënat dytësore janë të dhënat që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore.

#### Neni 8

### **Rregulla bazë të koordinimit**

1. Ndërveprimi ndërmjet bazave të të dhënave shtetërore bëhet vetëm me të dhënat parësore.
2. Ndalohet ndërveprimi i bazave të të dhënave shtetërore me të dhënat dytësore.

### KREU III

## **AUTORITETI RREGULLATOR KOORDINUES I BAZAVE TË TË DHËNAVE SHTETËRORE**

#### Neni 9

### **Autoriteti Rregullator Koordinues i bazave të të dhënave shtetërore**

Autoriteti Rregullator Koordinues i bazave të të dhënave shtetërore (në vijim Autoriteti Rregullator Koordinues), i cili është përgjegjës për rregullimin dhe koordinimin e përgjithshëm të bazave të të dhënave shtetërore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për shoqërinë e informacionit.

#### Neni 10

### **Përgjegjësitë e Autoritetit Rregullator Koordinues**

1. Autoriteti Rregullator Koordinues ka këto përgjegjësi:
  - a) përpunon, përditëson dhe standardizon procedura dhe rregulla për krijimin, regjistrimin, përfundimin funksionimit, administrimin, ndërveprimin dhe sigurinë e bazave të të dhënave shtetërore dhe elementeve të tjera specifike që lidhen me këto procese;
  - b) regjistron bazat e të dhënave shtetërore përpara se të vihen në përdorim;
  - c) miraton arkitekturën dhe strukturën e bazës së të dhënave shtetërore;
  - ç) kontrollon zbatimin e kërkesave teknike të bazës së të dhënave shtetërore;
  - d) kryen ose autorizon, nëpërmjet një ekspertize të kualifikuar e të pavarur, auditimin e bazës së të dhënave.
2. Procedurat dhe rregullat e detajuara për krijimin, regjistrimin, përfundimin e funksionimit, administrimin, ndërveprimin dhe sigurinë e bazave të të dhënave shtetërore miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës që mbulon veprimtarinë e Autoritetit Rregullator Koordinues.

#### Neni 11

### **Kundërvajtjet administrative**

1. Mosrespektimi i rregullave dhe procedurave të nxjerra në zbatim të pikës 2 të nenit 10 të këtij ligji, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.
2. Kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes i takon Autoritetit Rregullator Koordinues, në përputhje me aktet që parashikojnë kompetencat dhe ndarjen e përgjegjësive të institucionit. Kompetenca për shqyrtimin dhe për nxjerrjen e vendimit të kundërvajtjes administrative i takon titullarit të Autoritetit Rregullator.

3. Procedurat e ekzekutimit të vendimit bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 12

### **Bashkëpunimi me Autoritetin Rregullator Koordinues**

1. Institucionet administruese bashkëpunojnë me Autoritetin Rregullator Koordinues për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj.

2. Detyrimet e përcaktuara në këtë ligj në asnjë rast nuk përjashtojnë detyrimet që burojnë nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

KREU IV

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 13

### **Dispozitë kalimtare**

Ministri përgjegjës për shoqërinë e informacionit, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton për zbatim masat administrative për rregullimin, në përputhje me këtë ligj, të veprimtarisë së subjekteve që tërësisht ose pjesërisht kanë krijuar një ose më shumë baza të dhënash.

Neni 14

### **Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për të nxjerrë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore në zbatim të neneve 9 e 10 pika 2 të këtij ligji.

Neni 15

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6709, datë 6.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**VENDIM**

**Nr.752, datë 8.9.2010**

### **PËR MIRATIMIN E “STANDARDEVE TË SHËRBIMIT TË KUJDESTARISË PËR FËMIJËT NË NEVOJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 18 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1.Miratimin e “Standardeve të shërbimit të kujdestarisë për fëmijët në nevojë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Ngarkohet Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për nxjerrjen e udhëzimit në zbatim të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

## STANDARDET E SHËRBIMIT TË KUJDESTARISË PËR FËMIJËT NË NEVOJË GUSHT 2010

### SEKSIONI 1 FËMIJËT DHE TË RINJTË

#### 1. Sensi pozitiv i identitetit

Fëmijëve dhe të rinjve u ofrohet shërbim kujdestarie që promovon një sens pozitiv të identitetit të tyre.

#### 2. Familja dhe shokët

Fëmijët dhe të rinjtë në kujdestari inkurajohen dhe ndihmohen për të ruajtur dhe forcuar lidhjet me familjen dhe shokët.

#### 3. Të drejtat e fëmijëve

Fëmijët dhe të rinjtë duhet të trajtohen me dinjitet dhe privatësia e tyre duhet respektuar. Në bazë të informacionit që u ofrohet, në përputhje me moshën, ata bëjnë zgjedhjet e tyre dhe kanë pikëpamjet e tyre të pavarura, përfshirë edhe ankimet të cilat duhen dëgjuar dhe konsideruar në të gjitha vendimet e marra lidhur me mirëqenien e tyre.

#### 4. Vlerësimi i ndryshimeve

Fëmijëve dhe të rinjve u ofrohet shërbim kujdestarie duke marrë në konsideratë moshën, nivelin e zhvillimit, nevojat individuale të vlerësuara, gjendjen shëndetësore, paafësinë, gjininë, situatën familjare, kulturën, përkatësinë etnike, besimin fetar dhe identitetin seksual.

#### 5. Fëmija dhe punonjësi social

Një punonjës social për çdo fëmijë/të ri të vendosur në kujdestari

#### 6. Vlerësimi i fëmijëve

Vlerësimi i nevojave të fëmijës duhet bërë përpara se fëmija të sistemohet në familjen kujdestare. Vetëm në rastet emergjente vlerësimi i nevojave të fëmijës bëhet pas sistemimit, por sa më shpejt të jetë e mundur.

#### 7. Plani i kujdesit dhe vlerësimet

Për çdo fëmijë në kujdestari hartohet një plan individual kujdesi. Fëmijët në varësi të moshës, si dhe pjesëtarët e familjes marrin pjesë në hartimin e planit të kujdesit.

#### 8. Përshtatja e familjes kujdestare me fëmijën

Fëmijët dhe të rinjtë sistemohen në familje kujdestare të cilat përzgjidhen në bazë të kapaciteteve të tyre për të përmbushur nevojat e vlerësuara të fëmijëve.

#### 9. Një ambient i sigurt dhe pozitiv

Familjet kujdestare sigurojnë një ambient të sigurt, të shëndetshëm dhe pozitiv për fëmijën.

#### 10. Siguria dhe mbrojtja e fëmijëve

Fëmija / i riu në kujdestari është i mbrojtur nga abuzimi dhe neglizhimi.

#### 11. Shëndeti dhe zhvillimi

Nevojat për shëndet dhe zhvillim për fëmijët dhe të rinjtë e vendosur në kujdestari vlerësohen dhe plotësohen.

#### 12. Edukimi

Nevojave për edukim të fëmijës në kujdestari u kushtohet vëmendje dhe u jepet prioritet i veçantë. Fëmijët inkurajohen dhe mbështeten për të arritur potencialin e tyre të plotë. Edukimi përfshin edhe përgatitjen e fëmijës me aftësitë e duhura sociale dhe praktike për jetën.

13. Përgatitja e fëmijës/të rinjve për t'u larguar nga familja kujdestare  
Fëmijët dhe të rinjtë ndihmohen në drejtim të zhvillimit të aftësive, njohurive dhe kompetencave të nevojshme për një jetë të pavarur. Atyre u jepet mbështetje dhe udhëzime të vazhdueshme për ta përballuar pozitivisht largimin nga familja kujdestare.

## SEKSIONI 2 PRINDËRIT KUJDESTARË

14. Vlerësimi dhe miratimi i prindërve kujdestarë me lidhje ose pa lidhje gjaku  
Prindërit kujdestarë aplikues i nënshtrohen vlerësimit për aftësitë e tyre për të kryer detyrën e kujdestarit të cilët fillimisht miratohen nga Komisioni Multidisiplinar i Kujdestarisë dhe më pas nga gjykata, e cila jep vendimin final të vendosjes së një fëmije në kujdestari.

15. Monitorimi dhe mbështetja  
Familja e aprovuar kujdestare, ku është sistemuar një fëmijë, monitorohet nga një punonjës social i kualifikuar. Ky person mundëson dhe siguron që familja kujdestare të ketë akses në informacione, shërbime dhe mbështetje profesionale, me qëllim që fëmijës në nevojë t'i ofrohet një shërbim cilësor.

16. Trajnimi  
Prindërit kujdestarë janë të detyruar të marrin pjesë në trajnime të vazhdueshme për t'u pajisur me njohuri dhe për t'u aftësuar në ofrimin e një shërbimi kujdestarie cilësor.

17. Rivlerësimi i prindërve kujdestarë  
Prindërit kujdestarë marrin pjesë në rivlerësime të rregullta që kanë të bëjnë me kapacitetin e tyre për të ofruar një shërbim cilësor dhe për të identifikuar boshllëqet gjatë shërbimit të kujdestarisë.

## SEKSIONI 3 INSTITUCIONET DHE STRUKTURAT E PËRFSHIRA NË SHËRBIMIN E KUJDESTARISË

18. Politika efektive për kujdestarinë  
Këshilli bashkiak/ i komunës dhe struktura të tjera lokale miratojnë politikat rajonale të kujdestarisë për fëmijë, alokojnë fondet e nevojshme për promovimin dhe ofrimin e shërbimeve parandaluese, të kujdestarisë, si dhe alternativave të tjera për mbrojtjen e sigurt të fëmijëve dhe të rinjve në nevojë.

19. Menaxhimi dhe monitorimi i shërbimit të kujdestarisë  
Pushteti vendor është përgjegjës për përzgjedhjen cilësore të familjeve kujdestare. Ai organizon dhe plotëson të gjitha kushtet e domosdoshme për ofrimin e shërbimit të kujdestarisë në komunitetin e vet, në përputhje me standardet shtetërore të shërbimit të kujdestarisë, duke qenë subjekti përgjegjës për zbatimin e kushteve ligjore, standardeve dhe ofrimin të shërbimit me profesionalizëm nga punonjësit socialë dhe kujdesit nga familjet kujdestare. Inspektorati i Ndhmës Ekonomike, Pagesës për Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore është përgjegjës për monitorimin e standardeve të shërbimit të kujdestarisë në të gjithë vendin.

20. Trajnimi dhe kualifikimi  
Institucionet e përfshira në ofrimin e shërbimit të kujdestarisë publike apo private, organizatat joqeveritare, agjenci të licencuara rekrutojnë staf profesionist, të kualifikuar për të siguruar një shërbim cilësor për fëmijët në nevojë.

21. Kujdestari cilësor për fëmijët në nevojë ofrohet nga familje kujdestare të trajnuara dhe të gatshme për ofrimin e shërbimit

Pushteti vendor, shërbimet e përkujdesit komunitar, organizatat dhe agjencitë e licencuara, bazuar në nevojat e identifikuara në bashkitë/komunat përkatëse mundësojnë dhe sigurojnë familjet kujdestare të gatshme për sistemimin e fëmijëve në nevojë në kujdestari.

## 22. Familja kujdestare për kujdes të veçantë

Pushteti vendor, shërbimet e përkujdesit komunitar, organizatat dhe agjencitë e licencuara, bazuar në nevojat e identifikuara në bashkitë/komunat përkatëse mundësojnë dhe sigurojnë familjet kujdestare të posaçme për fëmijët / të rinjtë me aftësi të kufizuara, apo me probleme në sjellje etj.

## 23. Komisionet multidisiplinare të kujdestarisë

Komisionet Multidisiplinare të Kujdestarisë të ngritura pranë Sektorit të Shërbimeve Sociale në bashkitë dhe komunat përkatëse janë një organizëm i përbërë nga përfaqësues të disiplinave të ndryshme. Ata mundësojnë verifikimin e cilësisë së procedurave të ndjekura në vlerësimin e familjeve kujdestare. Ata rekomandojnë një familje kujdestare në interesin më të mirë të fëmijës.

## 24. Deklarimi i shqetësimeve dhe ankimi

Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore në nivel qendror dhe rajonal, zyra e ndihmës dhe e përkujdesjes shoqërore në bashki / komunë, organizatat joqeveritare / agjenci të licencuara në ofrimin e shërbimit të kujdestarisë, kanë procedura të qarta për të siguruar që fëmijët, familjet e tyre, familjet kujdestare dhe të tjerë persona dashamirës dhe të interesuar mbi mirëqenien e fëmijës, të deklarojnë shqetësimet dhe ankesat rreth çdo aspekti të shërbimit të kujdestarisë.

# SEKSIONI 1 FËMIJËT DHE TË RINJTË

## 1. Sensi pozitiv i identitetit

Fëmijëve dhe të rinjve u ofrohet shërbim kujdestarie që promovon një sens pozitiv të identitetit të tyre.

### Kriteret:

1.1 Prindërit kujdestarë dhe punonjësit socialë promovojnë vetëbesimin dhe vetëvlerësimin e fëmijëve të sistemuar në kujdestari duke ndjekur këto hapa në punën e tyre:

- Dëgjojnë fëmijët me vëmendje;
- Përfshijnë fëmijët në marrjen e vendimeve gjatë qëndrimit në kujdestari, në përputhje me moshën, pjekurinë dhe zhvillimin e tyre mendor;
- Demonstronë respekt për fëmijët, familjet e tyre, kulturën, identitetin, besimin, racën, nivelin e zhvillimit dhe gjendjen shëndetësore;
- Punojnë dhe bashkëpunojnë me familjet biologjike.

1.2 Strukturat në nivel lokal i përqendrojnë përpjekjet e tyre të para në gjetjen e një familjeje kujdestare me lidhje gjaku, por që mund të sigurojë një shërbim të përshtatshëm lidhur me nevojat e vlerësuara të fëmijëve. Këto përpjekje pasqyrohen në dosjen individuale të fëmijës.

1.3 I jepet prioritet sistemimit të motrave dhe vëllezërve së bashku duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve, me përjashtim të rasteve të veçanta.

1.4 I jepet prioritet sistemimit të fëmijëve në komunitetin e tyre, me përjashtim të rasteve të veçanta.

1.5 Planet e kujdesit për fëmijën mundësojnë ruajtjen e marrëdhënieve ndërmjet fëmijëve dhe familjeve të tyre, shokëve, miqve dhe komunitetit. Prindërit kujdestarë dhe punonjësit socialë duhet të mbështesin realizimin e planeve individuale të kujdesit duke i kushtuar një rëndësi të veçantë dokumentimit të momenteve të rëndësishme në jetën e fëmijës.

1.6 Duke konsideruar interesin më të mirë të fëmijës, të ndiqet e njëjta shkollë që është frekuentuar edhe më parë, nëse kjo është e mundur.

1.7 Punonjësit socialë, prindërit kujdestarë dhe profesionistët e tjerë nuk duhet të jenë paragjykes ndaj familjeve biologjike.

1.8 Fëmijës i duhet dhënë informacion i saktë, i kuptueshëm, i përshtatshëm mbi historinë e familjes dhe lidhjet familjare si nga prindërit biologjikë ashtu edhe nga ata kujdestarë.

1.9 Punonjësit socialë plotësojnë dhe mbajnë dosje për fëmijën ku pasqyrohet informacion mbi procesin e sistemimit, ecurisë së fëmijës në kujdestari.

1.10 Prindërit, persona me lidhje gjaku dhe të tjerë persona që kanë lidhje me fëmijën, si edukatorët, mësuesit, shokët etj., kontaktohen në procesin e mbledhjes së informacionit për fëmijën.

1.11 Prindërit kujdestarë kuptojnë rëndësinë e gjërave personale të fëmijës të lidhura me kujtimet dhe të kaluarën e tij, të cilat janë të rëndësishme për identitetin e fëmijës. Ata e respektojnë privatësinë e tij dhe mbështesin fëmijën për të ruajtur korrespondencën, kartolinat, fotografitë dhe gjëra të tjera të çmuara për të.

1.12 Fëmijët mbështeten nga punonjësit socialë, prindërit kujdestarë dhe profesionistë të tjerë për të kuptuar ngjarjet në jetën e tyre.

1.13 Duhet pasur parasysh që është në interesin e fëmijës të qëndrojnë në të njëjtën familje kujdestare gjatë gjithë periudhës që ai/ajo ka nevojë për këtë shërbim.

1.14 Nevojat specifike të fëmijëve me aftësi të kufizuar merren në konsideratë dhe plotësohen në atë mënyrë që promovon tek ata një sens pozitiv të identitetit.

## 2. Familja dhe shokët

Fëmijët dhe të rinjtë në kujdestari inkurajohen dhe ndihmohen për të ruajtur dhe forcuar lidhjet me familjen dhe shokët.

### Kriteret

2.1 Nevoja e fëmijëve për të ruajtur marrëdhëniet me familjet dhe shokët konsiderohet me rëndësi, gjatë vendosjes së tyre në kujdestari, veçanërisht kur ata sistemohen larg komuniteteve të tyre.

2.2 Motrat dhe vëllezërit sistemohen së bashku në kujdestari, kur kjo është e mundur. Në rast se ata nuk sistemohen bashkërisht, hartohen plane për takime sa më të shpeshta ndërmjet tyre sidomos krijimin e mundësive për të kaluar bashkë ditët e festave dhe fundjavat.

2.3 Punonjësit socialë duhet të tregohen të kujdesshëm në realizimin e takimeve të planifikuara të fëmijëve.

2.4 Familjet biologjike përfshihen në kujdesin ndaj fëmijëve duke bashkëpunuar me punonjësin social dhe familjen kujdestare me përjashtim të rasteve kur ndikimi i tyre mund të ketë efekte negative për mirëqenien e fëmijëve. Në të tilla raste arsyet e mospërfshirjes së tyre dokumentohen.

2.5 Familjet kujdestare duhet të informohen hollësisht mbi historinë personale të fëmijës dhe informacione të nevojshme mbi marrëdhëniet sociale të tij me familjen biologjike dhe të tjerë.

2.6 Fëmijët, në bashkëpunim me prindërit dhe punonjësit socialë, identifikojnë personat e rëndësishëm në jetën e tyre si miq, shok, fqinjë. Bëhen përpjekje për t'i siguruar fëmijës ruajtjen dhe forcimin e marrëdhënieve me ta. Monitoruesit kanë procedura të caktuara për të monitoruar planet për kontaktet e fëmijës, realizimin dhe rishikimin e tyre.

2.7 Fëmijët inkurajohen të ruajnë marrëdhëniet me njerëzit që duan nëpërmjet përdorimit të telefonit, letrave dhe internetit.

2.8 Takimet e fëmijës me njerëzit që dëshiron të ruajë marrëdhënie mund të realizohen në shtëpinë e prindërve kujdestarë ose jashtë saj. Punonjësit socialë mbështesin dhe kontribuojnë në realizimin e këtyre takimeve.

2.9 Kur punonjësve socialë u duhet të monitorojnë takimet ndërmjet fëmijës dhe familjes biologjike, është e domosdoshme që t'u shpjegohen paraprakisht arsyet e këtij monitorimi. Punonjësi social diskuton me ta se si ky monitorim të mos kthehet në një shqetësim, por të ruajë funksionin e tij mbrojtës. Vendimi për monitorimin e takimeve rishikohet gjatë rivlerësimeve periodike. Gjithçka dokumentohet në dosjen personale.

2.10 Prindërit dhe persona të tjerë të rëndësishëm për fëmijën informohen vazhdimisht mbi ngjarje të rëndësishme të jetës së fëmijës dhe kjo dokumentohet në dosjen e tij/saj.

2.11 Prindërit dhe persona të tjerë të rëndësishëm për fëmijën nxiten të jenë pjesëmarrës në jetën e fëmijëve, në momentet e tyre më të rëndësishme me përjashtim të rasteve kur kjo gjykohet e dëmshme.

2.12 Kur fëmijët nuk mund të ruajnë kontaktet me familjen apo të tjerë, punonjësi social dhe familja kujdestare duhet të bisedojë me fëmijën herë pas here mbi arsyet dhe gjithçka të dokumentohet në dosjen personale.

2.13 Nevoja e fëmijës për të pasur marrëdhënie me bashkëmoshatarët është e rëndësishme. Kjo gjë realizohet me kujdes për t'i shërbyer mirëqenies së fëmijës.

## 3. Të drejtat e fëmijëve

Fëmijët dhe të rinjtë duhet të trajtohen me dinjitet dhe privatësia e tyre duhet respektuar. Në bazë të informacionit që u ofrohet, në përputhje me moshën, ata bëjnë zgjedhjet e tyre dhe kanë pikëpamjet e tyre të pavarura, përfshirë edhe ankimet të cilat duhen dëgjuar dhe konsideruar në të gjitha vendimet e marra lidhur me mirëqenien e tyre.

Kriteret:

Dinjiteti

3.1 Fëmijëve u sigurohet kujdes në përputhje me moshën, nivelin e zhvillimit, gjininë, kulturën, besimin, nevojat individuale dhe etnisë që i përkasin.

3.2 Fëmijët aftësohen të jenë të pavarur, në përputhje me moshën e tyre, stadin e zhvillimit dhe nevojave individuale.

Privatësia

3.3 Fëmijëve u mundësohet një kontakt pozitiv me familjen dhe shokët, kur kjo është në interesin e fëmijës.

3.4 Korrespondenca e fëmijëve me familjarë, të afërm, shokë edhe miq duhet lejuar dhe respektuar.

Zgjedhja

3.5 Fëmijët inkurajohen dhe u krijohen mundësi për të zhvilluar aftësitë, potencialet dhe interesat e tyre.

3.6 Fëmijët dëgjojnë, respektohen mendimet e tyre lidhur me kujdesin ndaj tyre dhe merren në konsideratë pikëpamjet e tyre, në përputhje me moshën, nivelin e zhvillimit dhe nevojat individuale.

3.7 Në raport me moshën, nivelin e zhvillimit dhe nevojat individuale, fëmijëve u mundësohet dhënia e informacionit lidhur me shërbime të ndryshme që ekzistojnë, në mënyrë që të kenë mundësi për të bërë zgjedhjet e duhura përse i përket mirëqenies së tyre. Fëmija këshillohet dhe mbështetet nga punonjësi social në rastet e përballjes me dilema të ndryshme. Ky informacion pasqyrohet në dosjen e fëmijës.

3.8 Fëmijët inkurajohen dhe aftësohen për të bërë zgjedhje personale nëpërmjet aktiviteteve të përditshme si p.sh. blerje veshjesh, kursim dhe shpenzim parash dhe hobeve të tyre.

3.9 Fëmijët informohen mbi procedurat e ankimit duke iu dhënë mundësi për të shprehur pakënaqësitë e tyre në lidhje me shërbimin. Atyre u jepet një kopje e këtyre procedurave në një format të përshtatur në lidhje me moshën respektive të fëmijëve dhe ata ndihmohen ta përdorin kur është e nevojshme. Ankesat duhet të konsiderohen seriozisht dhe të merren menjëherë masa për zgjidhjen e tyre mundësisht nga Ofruesi i Shërbimit të Kujdestarisë.

4. Vlerësimi i ndryshimeve

Fëmijëve dhe të rinjve u ofrohet shërbim kujdestarie duke marrë në konsideratë moshën, nivelin e zhvillimit, nevojat individuale të vlerësuara, gjendjen shëndetësore, paaftësinë, gjininë, situatën familjare, kulturën, përkatësinë etnike, besimin fetar dhe identitetin seksual.

Kriteret:

4.1 Fëmijët inkurajohen të kuptojnë dhe vlerësojnë trashëgiminë kulturore, etnike dhe fetare të tyre.

4.2 Aty ku është e mundur fëmijët sistemohen në familje kujdestare me të njëjtat përkatësi kulturore, etnike apo fetare. Në rast se kjo nuk realizohet prindërit kujdestarë mbështeten për t'u krijuar fëmijëve një mjedis inkurajues për njohjen dhe vlerësimin pozitiv të origjinës dhe prejardhjes së tyre.

4.3 Fëmijët inkurajohen dhe ndihmohen të kuptojnë dhe menaxhojnë më mirë situatat personale të aftësisë së kufizuar/sëmundjeje në përputhje me moshën, stadin e zhvillimit, nevojat individuale dhe dëshirat.

4.4 Fëmijët mbështeten dhe inkurajohen për t'u aftësuar në përballjen me forma të ndryshme të diskriminimit.

4.5 Fëmijët me aftësi të kufizuar marrin shërbimet e duhura dhe ndihmohen të rrisin kapacitetet e tyre duke u mbështetur me sistemimin në një familje kujdestare, e cila do të plotësojë më së miri nevojat e tyre specifike duke përfshirë një ambient fizik të përshtatur dhe pajisjet e nevojshme.

4.6 Fëmijët kanë të drejtë të jenë pjesëmarrës gjatë të gjithë procesit kur merren vendime që kanë të bëjnë me kujdesin ndaj tyre.

#### 5. Fëmija dhe punonjësi social

Një punonjës social për çdo fëmijë/të ri të vendosur në kujdestari

Kriteret:

5.1 Ofruesi i Shërbimit të Kujdestarisë përcakton një punonjës social për çdo fëmijë që në momentin e identifikimit të tij dhe përgjatë të gjithë kohës që fëmija qëndron në kujdestari.

5.2 Punonjësit socialë koordinojnë shërbimet e kujdesit ndaj fëmijës dhe kanë përgjegjësi për:

- sigurimin e zbatimit të standardeve;
- menaxhimin e procesit të vlerësimit;
- hartimin e planit individual të kujdesit dhe sigurimi i implementimit të këtij plani për çdo fëmijë;
- sistemimin e fëmijëve në kujdestari;
- organizimi i rivlerësimeve periodike dhe ndjekja e zbatimit të vendimeve të marra gjatë tyre;
- konsiderimin e mendimeve dhe opinioneve të fëmijëve dhe familjes biologjike, reflektimin e tyre në planin e kujdesit dhe përfshirjes së tyre gjatë zbatimit të këtij plani;
- vizitat në familjen kujdestare dhe takime me fëmijën, me një frekuencë të paktën çdo 2 javë;
- ruajtjen e marrëdhënieve të fëmijës me familjen biologjike dhe lehtësimin e kontakteve ndërmjet tyre duke konsideruar interesin më të mirë të fëmijës;
- ndërmarrjen e veprimeve të duhura në lidhje me ngjarje të veçanta duke siguruar një informim të saktë të familjes;
- sigurimin e mirëqenies së fëmijëve në mënyrë të vazhdueshme dhe ruajtjen e tyre nga abuzimi;
- mundësimin e ofrimit të shërbimeve të specializuara për fëmijën;
- koordinimin e shërbimeve të marra nga specialistë dhe institucione të ndryshme;
- dokumentimin e të gjitha informacioneve për çdo fëmijë në kujdestari duke përfshirë edhe vizitat dhe takimet me çdo fëmijë;
- informimin e fëmijëve mbi procedurat e ankimit duke iu dhënë mundësi për të shprehur pakënaqësitë e tyre në lidhje me shërbimin. Atyre u jepet një kopje e këtyre procedurave në një format të përshtatur dhe ata ndihmohen ta përdorin kur është e nevojshme.

#### 6. Vlerësimi i fëmijëve

Vlerësimi i nevojave të fëmijës duhet bërë përpara se fëmija të sistemohet në familjen kujdestare. Vetëm në rastet emergjente vlerësimi i nevojave të fëmijës bëhet pas sistemimit, por sa më shpejt të jetë e mundur.

Kriteret:

6.1 Vendimi për të sistemuar një fëmijë në kujdestari bazohet mbi një vlerësim social paraprak i cili përcakton nëse kjo është zgjidhja më e mirë në interes të fëmijës.

6.2 Punonjësi social bën të gjitha përpjekjet e mundshme që vlerësimi të arrihet para vendosjes së fëmijëve në kujdestari dhe brenda afateve kohore. Vlerësimi duhet bërë me profesionalizëm dhe në ekipe multidisiplinare. Ata marrin në konsideratë nevojat emocionale, psikologjike, shëndetësore, edukative të fëmijëve, gjithashtu edhe vlerësimet e mëparshme që mund të jenë bërë për fëmijën.

6.3 Për raste emergjente të sistemimit të fëmijës në kujdestari, brenda javës bëhet një vlerësim i shpejtë i cili duhet të kompletohet brenda 1 muaji. Sistemime emergjente të paplanifikuara bëhen vetëm në raste nevojash emergjente apo në rrethana të jashtëzakonshme dhe gjithçka duhet të pasqyrohet në dosjen e fëmijës.

6.4 Fëmijët, familjet e tyre dhe persona të tjerë të përfshirë në kujdesin ndaj tyre inkurajohen dhe mbështeten për pjesëmarrjen e tyre gjatë procesit të vlerësimit.

6.5 Rezultatet e vlerësimit u bëhen të ditur fëmijëve në mënyrë të kuptueshme me moshën e tyre, si dhe familjes biologjike dhe më pas familjes kujdestare. Raporti i vlerësimit paraqitet në



Komisionin Multidisiplinar të Kujdestarisë i ngritur pranë Sektorit të Shërbimeve Sociale në bashkitë dhe komunat

#### 7. Plani i kujdesit dhe vlerësimet

Për çdo fëmijë në kujdestari hartohet një plan individual kujdesi. Fëmijët në varësi të moshës, si dhe pjesëtarët e familjes marrin pjesë në hartimin e planit të kujdesit.

Kriteret:

7.1 Punonjësi social, duke u konsultuar gjithmonë me fëmijën, familjen biologjike, familjen kujdestare dhe persona të tjerë të rëndësishëm, harton planin e kujdesit për fëmijën i cili mbahet në dosjen e fëmijës. Institucionet që ofrojnë shërbime për fëmijë me aftësi të kufizuar përfshihen kur hartohet plani për një fëmijë me aftësi të kufizuar.

7.2 Plani i kujdesit për fëmijën përgatitet më parë se fëmija të vendoset në kujdestari. Për rastet emergjente lihet një afat 14-ditor.

7.3 Planet e kujdesit hartohen bazuar në nevojat e fëmijës.

7.4 Përmbajtja e një plani kujdesi:

- Qëllimi, afati dhe objektivat e sistemimit të fëmijës në kujdestari;
- Masat e nevojshme afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për kujdesin ndaj fëmijës;
- Detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej individëve në zbatimin e planit individual të kujdesit duke përfshirë dhe afatet kohore, si dhe planifikimin e vlerësimeve dhe rishikimit të planit të kujdesit;

- Mbështetja që do t'i ofrohet fëmijës dhe prindërve kujdestarë;
- Përcaktimi i angazhimeve të secilit në planin e kujdesit;
- Masat për shëndetin, edukimin, nevoja të veçanta të fëmijës, ruajtja e marrëdhënieve me familjen biologjike dhe të tjerë. (kush/kur/si)
- Parashikimet për vlerësimet periodike dhe rishikim të planit individual të kujdesit për fëmijën.

7.5 Hartimi i marrëveshjeve dhe nënshkrimi i tyre ndërmjet Strukturës së Shërbimeve Sociale në bashki/komunë /Ofruesit të Shërbimit të Kujdestarisë dhe prindërve biologjikë nëse ka të tillë, si dhe ndërmjet Strukturës së Shërbimeve Sociale në bashki/komunë/Ofruesit të Shërbimit të Kujdestarisë dhe familjes kujdestare, sipas planit të kujdesit.

7.6 Plani i sistemimit të fëmijës dhe i kujdesit u bëhet i njohur prindërve biologjikë të fëmijës, vetë fëmijës dhe prindërve kujdestarë. Në rast se kjo nuk ndodh për arsye të veçanta, gjithçka pasqyrohet në dosjen e fëmijës.

7.7 Vlerësimet periodike organizohen sipas afateve të parashikuara, por kur është e nevojshme mund të organizohen përpara këtyre afateve. Në raste të tilla plani individual i kujdesit rishikohet dhe ndryshohet në varësi të kushteve të mëposhtme:

- Situata e familjes biologjike ndryshon;
- Situata e familjes kujdestare ndryshon;
- Do të ishte në interesin më të mirë të fëmijës të kthehej në familjen biologjike;
- Plani i kujdesit dhe qëllimi i tij duhet të ndryshohet.

7.8 Vlerësimet periodike do të organizohen në mënyrë të tillë që t'u shërbejnë sa më mirë prindërve, fëmijëve dhe familjes kujdestare.

7.9 Fëmija dhe punonjësi social marrin pjesë në vlerësimet periodike të planit të kujdesit. Profesionistë të tjerë që kanë të bëjnë me edukimin, shëndetin, mbrojtjen, kujdesin, zhvillimin e fëmijës, mund të marrin pjesë direkt ose indirekt duke paraqitur një raport lidhur me këto aspekte që kanë të bëjnë me fëmijën.

7.10 Rezultatet e takimit diskutohen me fëmijën në varësi të moshës, stadit të zhvillimit dhe nevojave të fëmijës. Vendimet u bëhen të njohura prindërve, fëmijës, familjes kujdestare dhe një kopje e tyre mbahet në dosjen e fëmijës.

7.11 Kur një rast kujdestarie rrezikon të përfundojë në mënyrë të paplanifikuar, në këto raste bëhet një vlerësim i situatës aktuale dhe rishikim i planit individual të kujdesit për fëmijën.

7.12 Kur një rast kujdestarie përfundon në mënyrë të paplanifikuar organizohet një vlerësim për të marrë një vendim zyrtar, si dhe për të pasqyruar ndryshimin e situatës në planin individual të kujdesit për fëmijën.

## 8. Përshtatja e familjes kujdestare me fëmijën

Fëmijët dhe të rinjtë sistemohen në familje kujdestare të cilat përzgjidhen në bazë të kapaciteteve të tyre për të përmbushur nevojat e vlerësuara të fëmijëve.

Kriteret:

8.1 Komisioni Multidisiplinar kur merr vendimin paraprak për përzgjedhjen e familjes kujdestare, sigurohet për plotësimin e të gjitha nevojave të fëmijës nga familja kujdestare.

8.2 Fëmija ka mundësi të takohet dhe të njihet me familjen kujdestare edhe para se të sistemohet në kujdestari. Fëmijës i jepet mundësia të kalojë pak kohë në atë familje kujdestare si pjesë e procesit të përshtatjes dhe të formimit të mendimit vetjak e të pavarur, lidhur me jetesën në atë familje.

8.3 Mendimet dhe opinionet e fëmijës për t'u sistemuar në një familje të caktuar kujdestare, merren në konsideratë duke pasur parasysh moshën e fëmijës, stadin e zhvillimit dhe nevojat individuale të tij.

8.4 Përzgjedhja e familjes kujdestare për një fëmijë të caktuar bëhet nga Komisioni Multidisiplinar nëpërmjet shqyrtimit të raporteve përfundimtare mbi vlerësimin e fëmijëve dhe familjeve kujdestare. Krahas tyre dëgjohej dhe mendimet e punonjësve të cilët kanë pasur kontakte të drejtpërdrejta me palët.

8.5 Përshtatshmëria arrihet nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe diskutimeve ndërmjet të gjithë profesionistëve, fëmijëve dhe familjeve biologjike, familjeve kujdestare dhe fëmijëve të tyre.

8.6 Punonjësit socialë mbështesin krijimin e marrëdhënieve ndërmjet fëmijës me familjen kujdestare për të lehtësuar sistemimin e fëmijës në familjen kujdestare.

8.7 I njëjti proces ripërsëritet në raste të ndryshimit të rrethanave dhe nevojës për të sistemuar fëmijën në një familje tjetër kujdestare.

## 9. NJË AMBIENT I SIGURT DHE POZITIV

Familjet kujdestare sigurojnë një ambient të sigurt, të shëndetshëm dhe pozitiv për fëmijën.

Kriteret:

9.1 Fëmijës i ofrohet kujdes dhe afekcion në familjen kujdestare. Ata vlerësohen, mirëprehen dhe mbështeten. Mirëqenies së tyre dhe plotësimin të nevojave i kushtohet vëmendje e veçantë.

9.2 Prindërit kujdestarë krijojnë një ambient stimulues, mundësira që fëmija të luajë dhe të argëtohet.

9.3 Fëmija inkurajohet dhe mbështetet për të ruajtur lidhjet familjare, miqësitat e mëparshme dhe për të krijuar marrëdhënie të reja, kur këto marrëdhënie konsiderohen në interes të fëmijës.

9.4 Fëmijës i sigurohet veshje e përshtatshme në përputhje me moshën, seksin dhe stinët.

9.5 Fëmijës i sigurohet ushqim i shëndetshëm dhe i larmishëm, duke u përshtatur me preferencat kulturore, etnike, personale apo ndonjë kërkesë tjetër të veçantë të tij.

9.6 Kur bëhet vlerësimi i familjes kujdestare duhet të merret në konsideratë dhe t'i kushtohet vëmendje që të vlerësohet akomodimi, mobilimi dhe pajisjet e tjera të shtëpisë duke u siguruar që ato të jenë:

- të sigurt;
- të përshtatshme për numrin e njerëzve që jetojnë në shtëpi;
- të kenë një standard rregull dhe higjienë;
- të plotësojnë nevojat e fëmijës për hapësirë dhe privatësi.

9.7 Banesa e familjes kujdestare nuk ka objekte që mund të përbëjnë rrezikshmëri për fëmijën.

9.8 Prindërit kujdestarë marrin përgjegjësi që transportimi i fëmijëve të bëhet me mjete të sigurt.

## 10. Siguria dhe mbrojtja e fëmijëve

Fëmija / i riu në kujdestari është i mbrojtur nga abuzimi dhe neglizhimi.

Kriteret:

10.1 Punonjësit socialë gjatë trajnimeve për prindërit kujdestarë i kushtojnë kujdes dhe rëndësi përgatitjes së tyre në këto drejtime:

- Kujdesi i veçantë për fëmijët që kanë qenë të neglizhuar apo të abuzuar;
- Praktikant e një kujdesi të sigurt në të gjitha aspektet;
- Njohje dhe raportim të shenjave të abuzimit;
- Njohja, kuptimi dhe menaxhimi i sjelljeve shqetësuese;
- Mbatje shënimesh lidhur me fëmijën që nga momenti i vendosjes së tij në kujdestari e në vazhdim.

10.2 Punonjësit socialë këshillojnë prindërit kujdestarë mbi kuptimin dhe ushtrimin e përgjegjësive të tyre ligjore dhe sigurojnë që ata të jenë të qartë dhe të ndërgjegjësuar mbi mospërdorimin e asnjë forme dënimi fizik të tilla, si: shpulla, pickimi, shkundja, kërcënimi, ofendimi etj.

10.3 Prindërit kujdestarë dhe punonjësit socialë janë të ndërgjegjshëm mbi situatën e fëmijës të sistemuar në kujdestari. Për këtë duhet të ekzistojnë procedura që ndihmojnë në identifikimin e çdo forme të abuzimit ndaj fëmijës qoftë kjo edhe diçka e momentit.

10.4 Prindërve kujdestarë u jepet informacion i plotë me shkrim mbi fëmijën e sistemuar në familjet e tyre, për t'u mundësuar mbrojtjen e fëmijës, veten dhe fëmijët e tyre apo persona të tjerë që mund të kenë kontakte me të. Ky informacion mbahet i fshehtë dhe në vende të sigurta.

10.5 Punonjësit socialë u japin udhëzime të qarta prindërve kujdestarë mbi hapat që duhet të ndërmerren, në rast se fëmijët largohen nga familja kujdestare.

10.6 Si rregull, në një familje kujdestare sistemohen jo më shumë se dy fëmijë. Për vëllezërit dhe motrat bëhet kujdes që ata të vendosen së bashku. Në këtë rast nuk sistemohen fëmijë të tjerë në atë familje.

10.7 Prindërit kujdestarë kanë të drejtë të refuzojnë vendosjen e fëmijëve në familjet e tyre për arsye që ata i bëjnë të qarta. Prindërit kujdestarë vihen në dijeni të kësaj të drejte. Arsyet e tyre dëgjohen me vëmendje dhe merren në konsideratë.

10.8 Ofruesi i Shërbimit të Kujdestarisë merr masa që prindërve kujdestarë t'u ofrohet këshillim dhe mbështetje me shërbime të tjera në varësi të nevojave.

10.9 Punonjësi social sigurohet që fëmija të përgatitet për t'u vetëmbrojtur dhe vetëkujdesur. Mbrojtja e fëmijës

10.10 Neglizhimi, abuzimi që ndodh apo ka ndodhur me fëmijën, kur ai është apo ka qenë në familjen kujdestare nga persona të familjes apo të tjerë që kanë pasur lidhje me fëmijën, trajtohet sipas ligjeve në fuqi.

10.11 Në rast të informacioneve lidhur me abuzime apo neglizhime ndaj fëmijës, merren menjëherë masa për të dërguar një ekspert të jashtëm, i cili verifikon gjendjen dhe jep gjykimin për vazhdimësinë e qëndrimit të fëmijës në atë familje kujdestare apo për ndryshimet e nevojshme.

10.12 Fëmijëve u jepen shpjegimet e nevojshme lidhur me situatën e shqyrtuar në përputhje me moshën e tyre.

10.13 Fëmijët në kujdestari, të cilët kanë deklaruar se përjetojnë abuzim apo neglizhim, sigurohen që shqetësimeve të tyre u është kushtuar vëmendje dhe po ndiqen seriozisht. Fëmijëve u ofrohet mbështetje e vazhdueshme, këshillim dhe terapi për t'i kaluar situatat me pasoja sa më të lehta.

10.14 Prindërit biologjikë njoftohen brenda tri ditëve nga fillimi i investigimit, me përjashtim të rasteve kur kjo do të dëmtonte investigimin apo cenonte mirëqenien e fëmijës.

10.15 Prindërit kujdestarë, ndaj të cilëve kryhen investigime, informohen me shkrim mbi:

- Akuzat dhe investigimin e nisur ndaj tyre, me përjashtim të rasteve kur kjo do të dëmtonte investigimin apo cenonte mirëqenien e fëmijës;

- Procedurën e investigimit dhe vlerësimit, si dhe informimin e herëpashershëm mbi zhvillimet e reja;

- Rezultatet e vlerësimit dhe investigimit.

10.16 Prindërit kujdestarë, ndaj të cilëve ka nisur investigimi, trajtohen gjatë gjithë kohës me respekt dhe dinjitet.

10.17 Zyrat, institucionet e kujdestarisë kanë procedura të qarta për prindërit kujdestarë, kur ata nuk janë të kënaqur me rezultatet e investigimit.

10.18 Kur ka filluar procesi i investigimit për raste të abuzimit apo neglizhimit ndaj fëmijës apo të dyshimeve mbi abuzim/neglizhim, familjes kujdestare dhe fëmijëve të sistemuar në kujdestari u ofrohet këshillim dhe mbështetje psikologjike.

10.19 Me mbarimin e investigimit, gjykata rikonsideron edhe njëherë sistemimin e fëmijës në kujdestari, bazuar në rezultatet e investigimit dhe vendimin e Komisionit Multidisiplinar.

10.20 Rezultatet e investigimit dokumentohen me shkrim dhe merren në konsideratë si një eksperiencë për t'u parandaluar në raste të tjera. Prindërit kujdestarë njihen me këto raste nga trajnimet që organizohen për to.

#### 11. Shëndeti dhe zhvillimi

Nevojat për shëndet dhe zhvillim për fëmijët dhe të rinjtë e vendosur në kujdestari vlerësohen dhe plotësohen.

##### Kriteret:

11.1 Marrëveshjet mbi trajtimin e problemeve shëndetësore dhe atyre dentare, të cilat janë hartuar sipas pikës 7.5 të këtyre standardeve, diskutohen me prindërit biologjikë dhe familjen kujdestare paraprakisht, si dhe në momentin që shfaqet nevoja. Atyre u jepet informacion me shkrim nga punonjësi social, lidhur me detyrimet dhe të drejtat e tyre kundrejt këtyre nevojave të fëmijës.

11.2 Para se fëmijët të sistemohen në familjen kujdestare, si rregull u bëhet një ekzaminim i përgjithshëm shëndetësor. Ekzaminimi i përgjithshëm shëndetësor bëhet nga prindërit biologjikë dhe nëse prej tyre nuk ekzistojnë mundësitë apo burimet financiare për t'i kryer këto ekzaminime, ato bëhen nga punonjësi social.

11.3 Fëmijët në kujdestari përfitojnë të gjitha shërbimet e nevojshme shëndetësore, dentare, psikiatrike, psikologjike dhe fizioterapeutike, sipas nevojave të tyre specifike.

11.4 Prindërit biologjikë, prindërit kujdestarë dhe punonjësi social shkëmbejnë informacion me mjekët me synimin e ofrimit të një kujdesi shëndetësor sa më të mirë.

11.5 Prindërit kujdestarë marrin të gjitha masat e mundshme për të përmirësuar shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës, ndërkohë që ata jetojnë në familjen kujdestare.

11.6 Prindërit kujdestarë menaxhojnë situatat urgjente dhe ofrojnë ndihmën e parë në rast se fëmijët kanë nevojë për një gjë të tillë.

11.7 Prindërit kujdestarë kërkojnë ndihmën e duhur mjekësore në rastet kur fëmijët sëmuren apo vriten.

11.8 Prindërit kujdestarë janë të detyruar të informojnë punonjësit socialë dhe prindërit biologjikë, lidhur me problemet shëndetësore të fëmijës.

11.9 Prindërit kujdestarë mbajnë shënime mbi mjekimet që i janë bërë fëmijës, si dhe mbi momente të tjera të rëndësishme: oreksi, temperatura etj.

11.10 Në planet e kujdesit përcaktohen qartë të gjithë hapat për kujdesin ndaj fëmijës mbi çështje të zhvillimit fizik, emocional, seksual dhe shëndetësor.

11.11 Fëmijëve u jepet informacion mbi historikun e tyre të zhvillimit dhe atë shëndetësor në përputhje me moshën, stadin e zhvillimit dhe nevojat individuale.

11.12 Prindërit kujdestarë marrin trajnim nga Ofruesi i Shërbimit të Kujdestarisë, sipas pjesës 16-të të këtyre standardeve, lidhur me kujdesin shëndetësor, ndihmën e parë dhe higjienën duke vënë theksin veçanërisht te sëmundjet e transmetueshme dhe zhvillimi i përgjithshëm i fëmijës.

#### 12. Edukimi

Nevojave për edukim të fëmijës në kujdestari u kushtohet vëmendje dhe u jepet prioritet i veçantë. Fëmijët inkurajohen dhe mbështeten për të arritur potencialin e tyre të plotë. Edukimi përfshin edhe përgatitjen e fëmijës me aftësitë e duhura sociale dhe praktike për jetën.

##### Kriteret:

12.1 Ofruesi i shërbimit të kujdestarisë dhe punonjësit socialë bashkëpunojnë me shkollën për të siguruar vazhdimësinë dhe cilësinë e arsimimit të fëmijës së vendosur në kujdestari.

12.2 Punonjësi social dhe prindërit kujdestarë, në bashkëpunim me stafin e shkollës, vlerësojnë nevojat për edukim të fëmijës dhe progresi dokumentohet në vlerësimet periodike, në planet e kujdesit dhe rishikimin e tyre. Në lidhje me edukimin e fëmijëve përcaktohen objektiva të

qarta dhe merren të gjitha masat për realizimin e tyre.

12.3 Rolet e prindërve kujdestarë, biologjikë dhe të punonjësve socialë për të mbështetur edukimin e fëmijës, përcaktohen qartë në planet e kujdesit. Përgjegjësia për të kontaktuar me shkollën përcaktohet qartë dhe pasqyrohet në planin e kujdesit.

12.4 Punonjësit socialë, prindërit biologjikë dhe ata kujdestarë shkëmbejnë informacione me shkollën për t'u ofruar fëmijëve një ndihmë sa më të mirë. Në këtë rast punonjësi social duhet të sigurohet se konfidencialiteti, lidhur me informacionin mbi fëmijën, respektohet nga personeli i shkollës.

12.5 Edukimit të fëmijës në familjen kujdestare i jepet rëndësia e duhur. Prindërit kujdestarë kujdesen që fëmijët të kenë gjithçka që u duhet për një frekuentim dhe mbarëvajtje në shkollë, si librat, uniformën, ndihmën për përgatitjen e mësimeve dhe mbështetjen morale dhe praktike për pjesëmarrje në aktivitetet jashtëshkollore.

12.6 Prindërit kujdestarë ofrojnë mundësi për përgatitjen e fëmijës me aftësitë e duhura sociale dhe praktike për jetën duke nxitur dhe mbështetur pjesëmarrjen në sporte/arte dhe ndjekjen e interesave të veçanta të tyre.

12.7 Fëmijët e moshës parashkollore nxiten dhe mbështeten në zhvillimin e tyre dhe përmirësimin e aftësive sociale nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme grupi.

12.8 Në rastet kur fëmijët kalojnë nga një nivel arsimor tek tjetri, vlerësohen gjithnjë mundësitë më të mira për të vazhduar shkolla profesionale apo studimet e larta, në përputhje me prirjet, interesat dhe aspiratat që kanë fëmijët. Kjo gjë specifikohet në planet e kujdesit të tyre.

12.9 Punonjësit socialë dhe prindërit kujdestarë janë në dijeni të procedurave të përjashtimit të një fëmije nga shkolla dhe të ankimimit në të tilla raste.

13. Përgatitja e fëmijës/të rinjve për t'u larguar nga familja kujdestare

Fëmijët dhe të rinjtë ndihmohen në drejtim të zhvillimit të aftësive, njohurive dhe kompetencave të nevojshme për një jetë të pavarur. Atyre u jepet mbështetje dhe udhëzime të vazhdueshme për ta përballuar pozitivisht largimin nga familja kujdestare.

Kriteret:

13.1 Zyra e ndihmës dhe përkujdesit shoqëror në bashki/komunë kanë politika për kujdesin ndaj fëmijës pas përfundimit të kujdestarisë. Kjo parashikon të drejtat dhe mbështetjen për të rinjtë që do të largohen nga kujdestaria për një jetë të pavarur.

13.2 Për rastet e të rinjve që arrijnë moshën për t'u larguar nga kujdestaria për një jetë të pavarur, duhet që të paktën 2 vjet para këtij momenti të parashikohet në planin individual të kujdesit mbështetja e nevojshme financiare dhe personale që do t'i jepet fëmijës pas largimit. Vëmendje duhet t'i kushtohet dhe çdo aspekti tjetër të lidhur me momentet e krizave apo gëzimeve/festave.

13.3 Plani i kujdesit për largimin nga kujdestaria e një të riu me aftësi të kufizuar bëhet në marrëveshje dhe bashkëpunim me qendrat e zhvillimit të specializuara për shërbimet ndaj të rriturve, në mënyrë që të realizohet një largim sa më pak problematik.

13.4 Të rinjtë/fëmijët, familjet e tyre, punonjësit socialë, prindërit kujdestarë përfshihen në hartimin e planit të largimit të fëmijës nga familja kujdestare.

13.5 Fëmijët inkurajohen nga prindërit kujdestarë për t'u aktivizuar në rutinën ditore të jetës familjare, siç është blerja dhe përgatitja e ushqimit, dekorimi i shtëpisë dhe administrimi i parave të xhepit.

13.6 Shkalla e pavarësisë së lejuar për fëmijët/të rinjtë bazohet duke marrë në konsideratë moshën, stadin e zhvillimit, nivelin e të kuptuarit dhe aftësitë e fëmijës.

13.7 Planet e largimit nga kujdestaria përshtaten në përputhje me moshën, stadin e zhvillimit, nivelin e të kuptuarit dhe pjekurinë e tyre. Ky plan hartohet në varësi të planeve për të ardhmen, të cilat variojnë nga riintegrimi në familjen biologjike, në një familje tjetër kujdestare/adoptive apo kalimi në jetë të pavarur.

13.8 Fëmijët këshillohen dhe udhëzohen në lidhje me njohjen dhe orientimin për të marrë shërbimet e nevojshme në institucionet, zyrat, agjencitë e ndryshme në varësi të nevojave.

13.9 Prindërit kujdestarë mbështeten financiarisht, lidhur me kujdesin ndaj fëmijës/të riut në rastet kur edhe pse kanë arritur moshën 18-vjeçare ata vazhdojnë të jetojnë në familjen kujdestare kur është vlerësuar si e nevojshme.

## SEKSIONI 2 PRINDËRIT KUJDESTARË

14. Vlerësimi dhe miratimi i prindërve kujdestarë me lidhje ose pa lidhje gjaku

Prindërit kujdestarë aplikues u nënshtrohen vlerësimit për aftësitë e tyre për të kryer detyrën e kujdestarit, të cilët fillimisht miratohen nga Komisioni Multidisiplinar i Kujdestarisë dhe më pas nga gjykata, e cila jep vendimin final të vendosjes së një fëmije në kujdestari.

Kriteret:

14.1 Ofruesi i Shërbimit të Kujdestarisë dhe Komisioni Multidisiplinar i Kujdestarisë, i ngritur pranë Sektorit të Shërbimeve Sociale në bashkitë dhe komunat, ka politika dhe procedura të qarta mbi vlerësimin dhe përzgjedhjen e prindërve kujdestarë, të cilat mundësojnë përzgjedhjen e familjes kujdestare më të përshtatshme për fëmijën.

14.2 Personat që aplikojnë për të qenë prindër kujdestarë, marrin fillimisht një informacion të qartë mbi:

- procesin e vlerësimit;
- kriteret mbi të cilat ata do të vlerësohen;
- cilësitë që priten të demonstrohen prej tyre;
- mbështetjen profesionale që ata do të kenë;
- masën e pagesës që do t'u ofrohet për mirërritjen dhe plotësimin e nevojave të fëmijës;
- procedurat e apelimit.

14.3 Personat që aplikojnë për të qenë prindër kujdestarë i nënshtrohen një vlerësimi formal, i cili bëhet nga një punonjës social i kualifikuar. Raporti i vlerësimit përfundon me një rekomandim të punonjësit social, lidhur me miratimin e aplikantit dhe se çfarë shërbimi është ai në gjendje që të ofrojë.

14.4 Ecuria e vlerësimit diskutohet hap pas hapi me aplikuesin. Procesi i vlerësimit duhet të përfundojë brenda një periudhe prej 2 muajsh me përjashtim të rasteve të cilat mund të kërkojnë më shumë kohë. Aplikanti vihet në dijeni për shtyrjen e afatit dhe arsyet e saj.

14.5 Procesi i vlerësimit shtrihet në të gjithë anëtarët e familjes kujdestare aplikante, duke përfshirë edhe fëmijët sipas moshës, zhvillimit dhe nevojave individuale.

14.6 Prindërit aplikues kanë të drejtë të kenë akses te raporti dhe ta plotësojnë atë nëse e konsiderojnë të nevojshme përpara se ky raport të paraqitet në Komisionin Multidisiplinar të Kujdestarisë.

14.7 Komisioni Multidisiplinar shqyrton informacionin e mbledhur nga të gjitha institucionet dhe burimet e mundshme lidhur me familjen aplikuese dhe anëtarët e saj.

14.8 Raportet vlerësuese merren në konsideratë nga Komisioni Multidisiplinar i Kujdestarisë. Ai merr vendim për ta rekomanduar aplikantin si prind kujdestar pranë gjykatës së rrethit, e cila merr vendimin përfundimtar për miratimin e tij si familje kujdestare. Familja kujdestare njoftohet me shkrim në lidhje me miratimin/refuzimin si familje kujdestare.

14.9 Pas miratimit nga gjykata si familje kujdestare, hartohet dhe nënshkruhet një marrëveshje ndërmjet strukturës së shërbimeve sociale në bashki/komunë / Ofruesit të Shërbimit të Kujdestarisë dhe prindit kujdestar, ku bëhen të qarta të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve gjatë procesit të sistemimit të fëmijës në kujdestari. Në të njëjtën kohë parashikohen edhe aspekte të tjera, të lidhura me monitorimin, supervizimin/inspektimin dhe gjithçka tjetër në interesin dhe sigurinë e fëmijës.

15. Monitorimi dhe mbështetja

Familja e aprovuar kujdestare, ku është sistemuar një fëmijë, monitorohet nga një punonjës social i kualifikuar. Ky person mundëson dhe siguron që familja kujdestare të ketë akses në informacione, shërbime dhe mbështetje profesionale, me qëllim që fëmijës në nevojë t'i ofrohet një shërbim cilësor.

Kriteret:

15.1 Ofruesi i Shërbimit të Kujdestarisë përcakton një punonjës social të kualifikuar për të monitoruar dhe mbështetur familjen kujdestare dhe fëmijën e vendosur në kujdestari.

15.2 Ofruesi i Shërbimit të Kujdestarisë ka protokolle të shkruara që:

- Përcaktojnë rolin e punonjësit social, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi, si dhe vlerësimin dhe mbështetjen e familjeve kujdestare;
- Përcaktojnë procedura të qarta të komunikimit me familjet kujdestare dhe institucionet e tjera të përfshira në shërbimin e kujdestarisë;
- Lehtësojnë hartimin dhe shkëmbimin e raporteve brenda afateve kohore të përcaktuara për sa i përket sistemimit të fëmijës.

15.3 Përgjegjësitë e punonjësit social në monitorimin dhe mbështetjen e familjes kujdestare përfshijnë:

- organizimin e trajnimeve;
- të sigurojë monitorimin dhe mbështetjen e prindërve kujdestarë dhe fëmijëve të tyre;
- të sigurojnë që prindërit kujdestarë i kuptojnë, respektojnë dhe zbatojnë standardet, procedurat dhe legjislacionin përkatës;
- të sigurojnë që prindërit kujdestarë të jenë të informuar dhe të këshillohen, lidhur me fëmijët në kujdestari duke përfshirë: historikun e tyre, shëndetin, edukimin, nivelin kulturor, besimin fetar, episode të neglizhimit apo abuzimit me të cilat fëmijët mund të jenë përballur;
- të sigurojnë që prindërve kujdestarë u jepet informacion me shkrim mbi procedura të ndryshme dhe inspektimet që mund të bëhen ndaj tyre, si dhe ndihma që mund t'u ofrohet në raste të tilla, si dhe për raste kur fëmija mund të largohet nga familja kujdestare;
- të sigurojnë mbështetje psiko-sociale në situatat kur kujdestaria mund të ndërpritet, fëmija largohet apo në momente të tjera kritike.

15.4 Punonjësi social takohet rregullisht me prindërit kujdestarë, si dhe organizon takime të veçanta me vetë fëmijët e tyre.

15.5 Në rastet kur lind e nevojshme që fëmija të lëvizë nga familja kujdestare në një familje tjetër, punonjësi social organizon takime në lidhje me rishikimin e planit individual të kujdesit, duke përcaktuar dhe rolin e familjes kujdestare në këtë plan.

15.6 Punonjësit socialë mbajnë shënime dhe dokumentojnë të gjitha kontaktet që realizohen me prindërit kujdestarë duke përshkruar çështjet e diskutuara, kërkesat e tyre për mbështetje suplementare dhe përgjigjet ndaj këtyre kërkesave.

15.7 Prindërit kujdestarë informohen mbi të drejtën e tyre për të pasur akses ndaj dokumentacionit që mbahet lidhur me to.

15.8 Sektori i shërbimeve sociale të bashkisë/komunës nxit dhe mbështet krijimin e grupeve të suportit komunitar për familjet dhe fëmijët në kujdestari.

15.9 Sektori i shërbimeve sociale të bashkisë/komunës planifikon dhe mundëson shërbime ndihme për situata emergjente, si për familjen kujdestare ashtu edhe për fëmijët e vendosur në kujdestari. Informacioni rreth këtyre shërbimeve transmetohet te prindërit kujdestarë dhe fëmijët.

## 16. Trajnimi

Prindërit kujdestarë janë të detyruar të marrin pjesë në trajnime të vazhdueshme për t'u pajisur me njohuri dhe për t'u aftësuar në ofrimin e një shërbimi kujdestarie cilësor.

Kriteret:

16.1 Ofruesi i Shërbimit të Kujdestarisë ka një strategji për të trajnuar familjen kujdestare, si dhe punonjësit e tjerë të përfshirë në këtë shërbim. Ky trajnim parashikon dhe realizon edhe trajnime për t'u përgjigjur sa më mirë nevojave të tjera specifike.

16.2 Programet trajnuese marrin në konsideratë nevojat e vlerësuara për trajnim, politikat për përkujdesin ndaj fëmijëve dhe zbatimin e tyre, përmirësimet e bëra në legjislacion, rezultatet e inspektimeve dhe praktikatat më të mira.

16.3 Programet e trajnimit vlerësohen dhe rishikohen vazhdimisht.

16.4 Ofruesi i Shërbimit të Kujdestarisë i organizon trajnimet, duke synuar inkurajimin dhe pjesëmarrjen e prindërve kujdestarë dhe të familjarëve të tyre në këto trajnime.

16.5 Organizimi i trajnimeve për familjet kujdestare u jep mundësi të gjithë pjesëmarrësve për të rritur kapacitetet e tyre përkujdesëse.

16.6 Prindërit kujdestarë dhe ata aplikues angazhohen seriozisht për të marrë pjesë në programet e trajnimit.

16.7 Atje ku është e nevojshme, prindërve kujdestarë u ofrohet trajnim specifik sipas nevojave të tyre dhe situatave që operojnë.

16.8 Punonjësit socialë dokumentojnë çdo trajnim të ndjekur nga çdo familje kujdestare.

16.9 Gjatë vlerësimeve periodike dhe rishikimit të planeve të kujdesit evidentohen nevojat për trajnime dhe kjo përbën një orientim për programet e trajnimit të ardhshëm.

17. Rivlerësimi i prindërve kujdestarë

Prindërit kujdestarë marrin pjesë në rivlerësime të rregullta që kanë të bëjnë me kapacitetin e tyre për të ofruar një shërbim cilësor dhe për të identifikuar boshllëqet gjatë shërbimit të kujdestarisë.

Kriteret:

17.1 Vlerësimi i parë bëhet pas vitit të parë të kujdestarisë. Rishikimet e ardhshme bëhen në periudha trevjeçare.

17.2 Çdo vlerësim dokumentohet.

17.3 Duke u bazuar në dokumentacion, vlerësimet marrin në konsideratë performancën e prindërve kujdestarë, ndryshime të rëndësishme në shëndetin, kushtet e tyre dhe nevojat për mbështetje dhe trajnim.

17.4 Punonjësi social përgatit një raport, i cili konsultohet dhe miratohet nga prindërit kujdestarë dhe nga anëtarë të tjerë të familjes.

17.5 Në raport paraqiten dhe pikëpamjet e fëmijës dhe në rast se konsiderohet e nevojshme dhe të prindërve biologjikë.

17.6 Raportet përmbajnë nevojat për trajnim dhe hapat që duhen ndërmarrë, lidhur me përmirësimin e shërbimit të kujdestarisë deri në vlerësimin tjetër.

17.7 Gjatë këtij procesi mund të marrin pjesë edhe nivele drejtuese.

17.8 Kur gjatë vlerësimit, palët bien dakord, atëherë në planin e kujdesit për fëmijën/fëmijët shtohen detyra të tjera sipas situatës. Në rast se prindërit kujdestarë nuk bien dakord, ato mund të kërkojnë takim me një drejtues.

17.9 Vendimet dhe vlerësimet dokumentohen në dosje dhe një kopje u jepet prindërve kujdestarë.

17.10 Vlerësime të tjera suplementare bëhen në raste të abuzimeve, neglizhimeve apo ankimeve serioze lidhur me familjen kujdestare.

### SEKSIONI 3

#### INSTITUCIONET DHE STRUKTURAT E PËRFSHIRA NË SHËRBIMIN E KUJDESTARISË

18. Politika efektive për kujdestarinë

Këshilli bashkiak/i komunës dhe struktura të tjera lokale miratojnë politikat rajonale të kujdestarisë për fëmijë, alokojnë fondet e nevojshme për promovimin dhe ofrimin e shërbimeve parandaluese, të kujdestarisë, si dhe alternativave të tjera për mbrojtjen e sigurt të fëmijëve dhe të rinjve në nevojë.

Kriteret:

18.1 Këshilli bashkiak/i komunës miraton politikat lokale, dimensionin e shërbimit të kujdestarisë për fëmijët e komunitetit të vet, duke i harmonizuar ato me politikat kombëtare, bazuar në vlerësimet e nevojave komunitare për këtë shërbim, të siguruar nga informacionet e ndryshme statistikore të mbledhura nga drejtoritë përkatëse (arsimi, shëndetësia, komisariatet e policisë, zyrat rajonale të shërbimit, informacionet qytetare etj.).

18.2 Bashkia/komuna, mbi bazën e identifikimit të nevojave dhe mundësive financiare dhe kapaciteteve të shërbimit, alokon fondet për të krijuar, mbajtur dhe zgjeruar shërbimin e kujdestarisë, sipas specifikave moshore, sociale të target grupeve të ndryshme të fëmijëve me probleme dhe në nevojë, për t'u vendosur dhe mbrojtur nga shërbimet që ofrojnë familjet kujdestare në komunitetin përkatës.

18.3 Këshilli bashkiak/i komunës aprovon strukturën e sektorit të shërbimit social, i cili është përgjegjës teknik për zbatimin e të gjitha procedurave ligjore, për ngritjen dhe zbatimin e shërbimit të kujdestarisë në zonën që ka nën juridiksion pushteti vendor përkatës.



18.4 Bashkia/komuna miraton projekte partneriteti, tipologji të reja, praktika të mira të shërbimit të kujdestarisë, vendos marrëdhënie kontraktuale bashkëpunimi me organizata/agjenci të licencuara, brenda apo jashtë vendit që kanë kapacitete dhe mundësi dhe shfaqin angazhim në zbatim të politikave lokale të kujdestarisë për fëmijë në nevojë.

18.5 Këshilli bashkiak/i komunës njihet dhe analizon (jo më pak se dy herë në vit) zbatimin e politikave lokale të shërbimit të kujdestarisë, bazuar në analizat dhe raportet formale dhe informale të monitorimit dhe inspektimit të shërbimit të kujdestarisë, me qëllim vlerësimin permanent të performancës së këtij shërbimi në çdo komunitet.

18.6 Pranë Zyrës së Ndihmës dhe Përkujdesit Shoqëror në bashki/komunë ngrihet Komisioni Multidisiplinar i Kujdestarisë për vlerësimin paraprak të rasteve të kujdestarisë për fëmijë, i cili në çdo kohë ka në dispozicion, të miratuara nga strukturat përgjegjëse vendimmarrëse, një numër familjesh të përzgjedhura dhe të trajnuara, të gatshme për të qenë familje kujdestare dhe për të ofruar shërbimin e kujdestarisë.

18.7 Sektori i shërbimeve sociale në bashki/komunë në raste të veçanta, kur është e nevojshme dhe në interes të plotësimit sa më mirë të kushteve të kujdestarisë, bashkërendon punën me sektorët homologë në bashki/komuna të tjera të vendit, në lidhje me transferimin e fëmijëve në familje kujdestare jashtëkomunitare, mbi bazën e marrëveshjeve ligjore dhe modaliteteve financiare, dy-ose shumëpalëshe.

18.8 Sektori i shërbimeve sociale në bashki/komunë mban regjistër specifik të evidentimit të fëmijëve në nevojë, gjeneraliteteve të tyre, të familjeve kujdestare, protokolle të rregullta (dokumentacionin ligjor) në lidhje me transferimin e fëmijëve në bashki/komuna të ndryshme të vendit.

#### 19. Menaxhimi dhe monitorimi i shërbimit të kujdestarisë

Pushteti vendor është përgjegjës për përzgjedhjen cilësore të familjeve kujdestare. Ai organizon dhe plotëson të gjitha kushtet e domosdoshme për ofrimin e shërbimit të kujdestarisë në komunitetin e vet, në përputhje me standardet shtetërore të shërbimit të kujdestarisë, duke qenë subjekti përgjegjës për zbatimin e kushteve ligjore, standardeve dhe ofrimin të shërbimit me profesionalizëm nga punonjësit socialë dhe kujdesit nga familjet kujdestare. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore është përgjegjës për monitorimin e standardeve të shërbimit të kujdestarisë në të gjithë vendin.

#### Kriteret:

19.1 Strukturat përgjegjëse të pushtetit vendor sigurojnë ofrimin në sasinë, cilësinë e kërkuar dhe në kohën e duhur të shërbimit të kujdestarisë nëpërmjet familjeve kujdestare për fëmijët në nevojë të komunitetit.

19.2 Pushteti lokal merr të gjitha masat e nevojshme që struktura të specializuara (sektori i shërbimeve sociale dhe Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore në nivel qendror dhe rajonal) të funksionojnë efektivisht duke monitoruar periodikisht (sipas standardeve) ofrimin e shërbimeve të mëposhtme:

- Evidentimin, përzgjedhjen dhe vlerësimin e fëmijëve në nevojë për shërbimin e kujdestarisë;
- Përgatitjen nga ekipi multidisiplinar i planit individual të përkujdesit për çdo fëmijë të sistemuar në kujdestari;
- Sigurimin e kushteve normale për të siguruar shërbim të personalizuar për fëmijën dhe organizimin e vlerësimeve periodike të cilësisë së tij;
- Përzgjedhjen me kriterë të rrepta ligjore dhe sociale të familjeve kujdestare;
- Vlerësimin e staturës qytetare, të garancive morale dhe kushteve materiale të jetesës që janë të domosdoshme për familjen që ofron kujdestari;
- Koordinimin e veprimtarisë kualifikuese të familjes kujdestare me strukturat e specializuara të Shërbimit Social Shtetëror për organizimin e procesit të trajnimit të tyre;
- Monitorimin, vlerësimin periodik të statutit të familjeve kujdestare, ndryshimet që ndodhin, mbi bazën e analizave dhe vlerësimeve të procesit monitorues:

19.3 Pushteti lokal për të përmbushur nevojat me shërbime në kuadrin e ofrimin të një shërbimi cilësor të kujdestarisë, mund të kontraktojë organizata joqeveritare/ agjenci të licencuara,

të cilat mund të angazhohen në përmbushjen e një shërbimi të caktuar apo të gjithë ciklit lokal/rajonat të shërbimit të kujdestarisë. Marrëveshje dypalëshe nënshkruhen ndërmjet tyre ku një vend të veçantë zënë procedurat e monitorimit të shërbimit.

19.4 Sektori i shërbimeve sociale pranë bashkive/komunave, Komisioni Multidisiplinar dhe Ofruesit e Shërbimit të Kujdestarisë kanë sistem të mbledhjes së informacionit dhe përpunimit të të dhënave mbi këto aspekte:

- Rekrutimi dhe sigurimi i numrit të nevojshëm të familjeve kujdestare në dispozicion të nevojave të identifikuar nga pushteti vendor;
- Numri i fëmijëve të sistemuar në kujdestari;
- Numri i fëmijëve në nevojë për një familje kujdestare;
- Vlerësimi i sistemimeve aktuale;
- Ankimimet e bëra lidhur me aspekte të ndryshme të shërbimit, procedurat e ndjekura për zgjidhjen e tyre dhe rezultatet e arritura;
- Fëmijë të sistemuar në kujdestari me marrëveshje dypalëshe jashtë territorit që ka në juridiksion pushteti vendor.

19.5 Niveli lokal i shërbimit të kujdestarisë përbëhet nga këto struktura që kanë përgjegjësi komplementare për zbatimin e shërbimit të kujdestarisë në komunitet:

- Zyrat e sektorit të shërbimeve sociale;
- Sektori i fëmijëve;
- Shërbimet e përkujdesit komunitar;
- Organizatat joqeveritare/agjenci të licencuara që njihin dhe kanë kapacitete të zbatojnë procedurat për përzgjedhjen e fëmijëve, të cilët kanë nevojë për shërbimin e kujdestarisë apo shërbime të tjera alternative, për përzgjedhjen e familjes kujdestare, sistemimin e fëmijëve në kujdestari, monitorimin dhe mbështetjen e fëmijës, të familjeve biologjike dhe të familjeve kujdestare për të përmbushur objektivat e planit individual të përkujdesit.

19.6 Për të ofruar shërbim cilësor të kujdestarisë për fëmijë në këto struktura përzgjidhet një staf profesionistësh, i kualifikuar dhe me eksperiencë.

19.7 Për të ofruar një shërbim cilësor kujdestarie nga pushteti lokal monitorohen:

- zbatimi i kritereve të përzgjedhjes së fëmijëve në nevojë për shërbim kujdestarie;
- zbatimi i procedurave në ofrimin e shërbimit të kujdestarisë;
- performanca e punonjësit social gjatë ofrimit të shërbimeve;
- zbatimi i planeve të kujdesit të fëmijës;
- zbatimi i procedurave në përzgjedhjen dhe rekrutimin e familjeve kujdestare;
- respektimi i afateve të vendosura;
- procesi i ankimimit, konsiderimi dhe zgjidhja e tyre;
- marrëdhënia me Komisionin Multidisiplinar të Kujdestarisë, linjat dhe cilësia e komunikimit.

19.8 Për të siguruar një shërbim cilësor të kujdestarisë, nga Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore në nivel rajonal monitorohen:

- Zbatimi i legjislacionit nga pushteti lokal, shërbimet e përkujdesit omunitar/organizata/agjenci të licencuara;
- Efektiviteti i përdorimit të fondeve;
- Zbatimi i standardeve të shërbimit;
- Zbatimi i procedurave dhe afateve kohore të parashikuara;
- Procesi i rekrutimit dhe trajnimit të familjes kujdestare;
- Funksionimi i strukturës përkatëse që merret me çështjet për fëmijët, organizatave/agjencive të licencuara në ofrimin e shërbimit cilësor të kujdestarisë;
- Mbledhja e informacionit, të të dhënave mbi nevojat për shërbim dhe përqindjen e plotësimin të tyre, evidenton arsyet e këtyre raporteve për ofrimin e shërbimit.

19.9 Për të siguruar një shërbim cilësor të kujdestarisë në të gjithë vendin, nga Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore monitorohen:

- zbatimi i legjislacionit për të identifikuar përmirësimet e nevojshme;

- zbatimi i standardeve;
- alokimin e fondeve dhe efektivitetin e përdorimit të tyre;
- funksionimin e të gjitha strukturave të përfshira në shërbimin e kujdestarisë;
- bashkëveprimin institucional;
- mbledhja dhe administrimi i informacionit të shërbimit të kujdestarisë në nivel kombëtar.

19.10 Sektori i shërbimeve sociale raporton në këshillin bashkiak/komunës për të gjitha aspektet e shërbimit të kujdestarisë duke përfshirë: rekrutimin dhe ruajtjen/mbajtjen e familjeve kujdestare; numrin e rasteve të vendosura në kujdestari, numrin e fëmijëve në nevojë në pritje për t'u vendosur në kujdestari; përshtatjen e fëmijës në familjen aktuale kujdestare, pasqyrimin dhe ankesat në lidhje me shërbimin e kujdestarisë; largimet nga shërbimi i kujdestarisë dhe perspektiva individuale e fëmijëve të larguar: procedurat e ndjekura në zgjidhjen e vështirësive dhe rezultatet e arritura.

19.11 Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore për të gjitha shkëlqet e vëna re njofton strukturën përgjegjëse të caktuar nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Struktura përgjegjëse në fund të çdo viti bën bilancin e inspektimit të standardeve të shërbimit të kujdestarisë në të gjithë vendin dhe mbi bazën e situatës nxjerr konkluzione për cilësinë, nevojat dhe bën propozime për ndërhyrje në kuadrin ligjor, përmirësimin e standardeve të shërbimit të kujdestarisë dhe standardeve të rekrutimit të familjes kujdestare, propozon për zgjerimin e tyre dhe fondeve sipas nevojave të identifikuara nga informacioni sasior dhe cilësor i grumbulluar nga organet e pushtetit vendor.

#### 20. Trajnimi dhe kualifikimi

Institucionet e përfshira në ofrimin e shërbimit të kujdestarisë, publike apo private, organizatat joqeveritare, agjenci të licencuara rekrutojnë staf profesionist, të kualifikuar për të siguruar një shërbim cilësor për fëmijët në nevojë.

##### Kriteret:

20.1 Institucionet e përfshira në ofrimin e shërbimit të kujdestarisë, publike apo private, agjenci të licencuara rekrutojnë staf profesionist, të kualifikuar për të siguruar një shërbim cilësor për fëmijët në nevojë.

20.2 Institucionet përgjegjëse hartojnë me saktësi detyrat e përgjegjësive të punonjësve të përfshirë në shërbimin e kujdestarisë.

20.3 Ekspertët identifikojnë nevojat për trajnime për të gjithë punonjësit e përfshirë në shërbimin e kujdestarisë.

20.4 Shërbimi Social Shtetëror (drejtoria e trajnimit, projekteve dhe monitorimit) vlerëson nevojat lokale dhe nacionale për kualifikimin e përgjithshëm dhe të specializuar të stafëve të politikëbërjes dhe zbatimit të shërbimit të kujdestarisë. Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me ekspertë, pedagogë të Fakultetit të Shkencave Sociale, organizata joqeveritare me ekspertizë harton kurrikula dhe module trajnimi dhe organizon trajnime për stafet që përfshihen në ofrimin e shërbimit të kujdestarisë nëpërmjet formimit të vazhduar të të gjithë aktorëve të përfshirë në hartimin e politikave, drejtimin e institucioneve sociale të pushtetit vendor dhe familjes kujdestare.

20.5 Sektori i Shërbimeve Sociale në bashki/komunë, struktura përkatëse që merret me çështjet për fëmijët në bashki/komunë, organizata, agjenci të kontraktuara për ofrimin e shërbimit të kujdestarisë përzgjedh familjet kujdestare, organizon dhe ndjek procesin e formimit dhe trajnimit të familjes kujdestare për të qenë e gatshme për të ofruar shërbimin e kujdestarisë. Kujdestaria cilësore për fëmijët në nevojë ofrohet nga familje kujdestare të trajnuara dhe të gatshme për të ofruar shërbimin.

21. Kujdestari cilësore për fëmijët në nevojë ofrohet nga familje kujdestare të trajnuara dhe të gatshme për ofrimin e shërbimit

Pushteti vendor, shërbimet e përkujdesit komunitar, organizatat dhe agjencitë e licencuara, bazuar në nevojat e identifikuara në bashkitë/komunat përkatëse, mundësojnë dhe sigurojnë familjet kujdestare të gatshme për sistemimin e fëmijëve në nevojë në kujdestari.

##### Kriteret:

21.1 Sektori i shërbimeve sociale në bashki/komunë, minibashkitë, organizata, agjenci të kontraktuara për ofrimin e shërbimit të kujdestarisë hartojnë strategji për rekrutimin e familjeve

kujdestare, duke vlerësuar informacionin dhe të dhënat e mbledhura lidhur me nevojat e fëmijëve për t'u vendosur në kujdestari duke vlerësuar kontingjentin e përzgjedhur të familjeve kujdestare me një profil të caktuar në përputhje me nevojat e fëmijëve që do të vendosen në kujdestari.

21.2. Seksioni i ndihmës dhe shërbimeve sociale në bashki/komunë, minibashkitë, organizata, agjenci të kontraktuara për ofrimin e shërbimit të kujdestarisë, zbatojnë procedura të caktuara për të standardizuar procedurat dhe përmirësuar mundësitë e përzgjedhjes së familjes kujdestare, në radhë të parë brenda rrethit të të afërmeve, miqve, dhe mundësisht brenda në komunitetin e fëmijëve në nevojë.

21.3 Pushteti vendor, Zyra e Ndihmës dhe Përkujdesit Shoqëror në bashki/komunë, shërbimet e përkujdesit komunitar, organizata dhe agjenci të licencuara organizojnë fushata publicitare për tërheqjen, seleksionimin dhe rekrutimin e familjeve në shërbimin e kujdestarisë. Në këtë proces synohet të përzgjidhen familje kujdestare, në përputhje me nevojat e fëmijëve dhe brenda komuniteteve ku ata jetojnë. Në këtë proces mendohet edhe për përzgjedhjen e familjeve kujdestare rezervë, familjet kujdestare në raste emergjente dhe ato të cilat do të shërbejnë si familje kujdestare në afate disaditore.

21.4 Fushatat publicitare vënë në përdorim të gjitha mjetet e medias së shkruar dhe asaj elektronike, kontaktime me përfaqësues të komunitetit, institucionet edukative, qendrat shëndetësore duke dhënë informacion të qartë, të plotë dhe të drejtpërdrejtë mbi shërbimin e kujdestarisë në të gjitha etapat e tij.

21.5 Struktura përkatëse që merret me çështjet për fëmijët, shërbimet e përkujdesit komunitar, organizata joqeveritare/agjenci të licencuara janë të gatshme të presin të interesuarit/aplikantët, të mundësojnë informimin e tyre paraprak mbi shërbimin dhe të organizojnë procesin e mëtejshëm të vlerësimit brenda afateve të përcaktuara kohore.

## 22. Familja kujdestare për kujdes të veçantë

Pushteti vendor, shërbimet e përkujdesit komunitar, organizatat dhe agjencitë e licencuara, bazuar në nevojat e identifikuar në bashkitë/komunat përkatëse, mundësojnë dhe sigurojnë familjet kujdestare të posaçme për fëmijët/të rinjtë me aftësi të kufizuara apo me probleme në sjellje etj.

### Kriteret:

22.1 Standarde dhe kriteret që zbatohen për shërbimin e kujdestarisë aplikohen po kështu edhe për rastet kur ofrohet shërbimi i kujdestarisë së posaçme. Përveç tyre hartohen dhe politika dhe procedura të posaçme për të mbështetur familjet kujdestare që ofrojnë kujdestari/kujdes të veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara apo me probleme të sjelljes.

22.2 Vlerësimi i fëmijëve me nevoja të veçanta kryhet nga Komisioni Multidisiplinar si për të gjithë fëmijët e tjerë, por në këtë rast angazhohen edhe profesionistë të fushës (si mjekë, edukatorë specialë, psikologë, psikiatër etj.), për të vlerësuar përmbushjen e kushteve të veçanta të familjes kujdestare, në përputhje me nevojat e identifikuar të fëmijës me aftësi të kufizuara /probleme të sjelljes.

22.3 Sektori i shërbimeve sociale në pushtetin vendor garanton se të gjithë personat e familjes për “kujdestari të posaçme” janë trajnuar për raste të veçanta dhe janë të aftë dhe me eksperiencë për të ofruar “kujdestarinë e posaçme”.

22.4 Për familjet kujdestare, që ofrojnë një kujdes të posaçëm janë të detyruara trajnime specifike dhe të vazhdueshme, në përputhje me nevojat e veçanta të fëmijëve me aftësi të kufizuara/ probleme të sjelljes dhe konform praktikave më të mira të shërbimit të kujdestarisë specifike.

22.5 Fëmijëve në kujdestari të posaçme u ofrohet arsimimi i përshtatshëm në varësi të moshës dhe zhvillimit.

## 23. komisionet multidisiplinare të kujdestarisë

Komisionet Multidisiplinare të Kujdestarisë, të ngritura pranë sektorit të shërbimeve sociale në bashkitë dhe komunat përkatëse, janë një organizëm i përbërë nga përfaqësues të disiplinave të ndryshme. Ata mundësojnë verifikimin e cilësisë së procedurave të ndjekura në vlerësimin e familjeve kujdestare. Ata rekomandojnë një familje kujdestare në interesin më të mirë të fëmijës.

### Kriteret:

23.1 Kriteret dhe procedurat që ato do të ndjekin për vlerësimin e familjes kujdestare, do të parashikohen në një akt nënligjor.

#### 24. Deklarimi i shqetësimeve dhe ankimimi

Inspektorati i Ndhmës Ekonomike, Pagesës për Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore në nivel qendror dhe rajonal, Zyra e Ndhmës dhe e Përkujdesjes Shoqërore në bashki / komunë, organizatat joqeveritare/agjenci të licencuara në ofrimin e shërbimit të kujdestarisë kanë procedura të qarta për të siguruar që fëmijët, familjet e tyre, familjet kujdestare dhe të tjerë persona dashamirës dhe të interesuar mbi mirëqenien e fëmijës, të deklarojnë shqetësimet dhe ankesat rreth çdo aspekti të shërbimit të kujdestarisë.

Kriteret:

24.1 Të gjitha strukturat e përfshira në shërbimin e kujdestarisë brenda dhe jashtë pushtetit vendor kanë procedura të qarta, të njohura dhe të afishuara publikisht të përgjegjësive, detyrimeve dhe të drejtave reciproke ndërmjet palëve të përfshira në shërbim, fëmija, familja kujdestare, familja biologjike, zyrat e pushtetit vendor, Inspektorati i Shërbimeve Shoqërore në nivel qendror dhe rajonal, media, shoqëria civile, grupet e interesit etj.

24.2 E drejta e ankimimit është pjesë e së drejtës së fëmijës dhe ato pasqyrohen dhe në marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet palëve.

Një kopje e shkruar e procedurave të ankimimit u jepet edhe fëmijëve në një format të përshtatur në përputhje me moshën, prindërve biologjikë dhe familjes kujdestare.

Ato janë të pasqyruara në mënyrë të dukshme në ambientin ku jeton fëmija dhe janë të hapura për të gjithë aktorët e shërbimit të kujdestarisë.

24.3 Familja kujdestare, prindërit biologjikë, të afërmit e fëmijës, përfaqësues të pushtetit vendor dhe të Komisionit Multidisiplinar të Kujdestarisë njohin përgjegjësitë, detyrimet dhe të drejtat e palëve në shërbimin e kujdestarisë, të cilat bazohen në standardet specifike të kujdestarisë.

24.4 Procedurat e ankimimit duhet të përmbajnë:

- Cilat nga deklaratat e bëra nga palët do të quhet ankesë;
- Si një fëmijë do të ndihmohet për të bërë një ankesë;
- Afate të përcaktuara për analizën e ankesës dhe kthimin e përgjigjes ndaj ankuesit;
- Hapat që do të ndiqen për të zgjidhur problemin (afatet kohore, personat përgjegjës për investigimin e problemit, ku dhe si do të dokumentohet informacioni i mbledhur, rezultatet e nxjerra rreth ankesës së bërë);

- Shkallë të tjera ku mund të apelojë personi, kur është i pakënaqur me rezultatet.

24.5 Ofruesi i Shërbimit të Kujdestarisë duhet:

- Të ndihmojë fëmijët, familjet e tyre, ato kujdestare dhe persona të tjerë të interesuar për mirëqenien e fëmijës, që të deklarojnë shqetësimet dhe ankesat rreth çdo aspekti të shërbimit të kujdestarisë;

- T'i informojë ata mbi të drejtën e tyre për të përfituar nga shërbimet falas, të cilat ekzistojnë brenda zyrës apo jashtë saj;

- Të lehtësojë përfitimet e tyre nga këto shërbime;

- Të sigurojë që zëri i palëve të interesuara, shqetësimet apo kërkesat e tyre të dëgjohen.

24.6 Procedura të qarta dhe të sakta të marrëdhënieve midis sektorit të shërbimeve sociale të pushtetit vendor, familjes kujdestare dhe fëmijës që është vendosur në kujdestari, kusht për vlerësimin e cilësisë dhe marrëdhënieve në shërbimin e kujdestarisë dhe kusht për të vlerësuar “kënaqësinë apo pakënaqësinë” e fëmijës që është vendosur në kujdestari të përkohshme.

Përfshirje në procesin e monitorimit të cilësisë së shërbimit, përveç strukturave të Inspektoratit të Shërbimeve Shoqërore në nivel qendror dhe rajonal edhe të vetë fëmijës, të afërmeve të tyre, apo përfaqësues nga strukturat e komunitetit dhe të shoqërisë civile që janë të interesuara për mbarëvajtjen e procesit të kujdestarisë.

24.7 Mënyra të qarta dhe procedura të lehta për të realizuar dhe bërë efektive të drejtën e fëmijës për ankimim në pushtetin vendor dhe në të gjitha nivelet e Inspektoratit të Ndhmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore.

**VENDIM**  
**Nr.759, datë 15.9.2010**

**PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE E TË STUDENTËVE, NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2010-2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1 e 5 të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimim dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 57 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike dhe studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, në institucionet arsimore publike, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

2. Përfitojnë bursë nxënësit dhe studentët, brenda kuotave dhe kriterëve të përcaktuara në këtë vendim:

2.1 Sipas kriterit ekonomik (nxënës/studentë):

a) Nxënësit/studentët, që vazhdojnë studimet larg vendbanimit të tyre në largësinë mbi 5 km dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Nxënësit që banojnë në fshat, të cilët nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km e që vendosen në konvikt publik.

c) Nxënësit/studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

ç) Nxënësit/studentët të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

d) Secili nga studentët bashkëshort me fëmijë, që plotëson kriterin ekonomik dhe që vendoset në konvikt publik.

dh) Fëmijët, nxënës apo studentë, që kanë statusin e invalidit, paraplegjikut dhe tetraplegjikut dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

2.2 Sipas rezultateve të arritura (nxënës/studentë):

a) Nxënësit e arsimit të mesëm profesional, që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta).

b) Nxënësit të cilët vazhdojnë studimet në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinare, pyjore dhe ndërtim, në vitet e dyta e lart, dhe që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 (tetë).

c) Studentët që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, që kanë mbaruar shkollën e mesme me Medalje Ari.

ç) Studentët që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, që janë shpallur nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës më të mirët e Maturës Shtetërore, sipas renditjes në listën e vlerësimit. Për vitin 2010, numri i tyre do të jetë 25 (njëzet e pesë) studentë. Kjo kategori studentësh përfiton bursë kur ata vazhdojnë studimet në institucionet e arsimit të lartë publik dhe vetëm për vitin shkollor 2010-2011.

d) Studentët që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta).

dh) Studentët që vazhdojnë studimet në specialitetin matematikë dhe në specialitetin fizikë, në vitet e dyta e lart, dhe kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 (tetë).

2.3 Jashtë kriterit ekonomik (nxënës/studentë):

a) Fëmijët, nxënës apo studentë, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës. Në fillim të çdo viti akademik Ministria e Brendshme, Shërbimi Informativ Shtetëror, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Mbrojtjes dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, listën për këtë kategori nxënësish/studentësh.

b) Nxënësit që vijnë nga zonat verilindore dhe juglindore të vendit (Tropoja, Hasi, Puka, Kukësi, Dibra, Bulqiza, Mati, Mirdita, Malësia e Madhe, Librazhdi, Gramshi, Kolonja, Përmeti, Pogradeci, Skrapari, Tepelena dhe rrethi Tiranë), të cilët regjistrohen dhe ndjekin studimet në vitin e parë shkollor 2010-2011, në shkollat e mesme profesionale.

2.4 Sipas degëve prioritare për zhvillimin e ekonomisë (nxënës):

Nxënësit që regjistrohen dhe të cilët ndjekin studimet në vitin e parë shkollor 2010-2011, në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinarë, pyjore, ndërtim dhe teknologji informacioni.

3. Nxënësit dhe studentët e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të bursës, kur:

a) janë ndarë nga trangu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;

ç) shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokalue.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes së bursave, për drejtoritë arsimore rajonale (DAR) dhe zyrat arsimore (ZA), për vitet e para, sipas kuotave të miratuara (për nxënës/studentë). DAR/ZA-të, pas këshillimit me njësitë e pushtetit vendor, hartojnë planin e shpërndarjes së bursave dhe e dërgojnë në njësitë e pushtetit vendor (bashki/komunë), në përshtatje me kërkesat e paraqitura paraprakisht prej tyre për kategoritë, sipas pikës 2.1.

5. Bashkitë dhe komunat, bazuar në planin e përcaktuar për to nga DAR/ZA-të, vendosin, me këshillat e tyre, për dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të këtij vendimi, duke u dhënë përparësi nxënësve dhe studentëve nga shtresat sociale në nevojë, për trajtimin me bursë të plotë ose, në pamundësi, trajtimin me gjysmë burse.

5.1 Bashkitë dhe komunat, detyrimisht, duhet t'u dërgojnë, në rrugë zyrtare, drejtorive arsimore rajonale apo zyra arsimore përkatëse, vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

5.2 Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore duhet të dërgojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, si dhe bashkive/komunave që menaxhojnë konviktet, listën emërore të studentëve dhe të nxënësve bursistë, së bashku me vendimet origjinale të këshillave të bashkive dhe të këshillave të komunave. Një kopje e listës emërore të studentëve dhe nxënësve të trajtuar me bursë dërgohet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

5.3 Plani i bursave për nxënësit që regjistrohen dhe vazhdojnë studimet në vitin e parë shkollor 2010-2011, në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinarë, pyjore dhe ndërtim, jepet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), për bashkinë dhe komunën përkatëse, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve në të cilat janë vendosur nxënësit, sipas numrit të nxënësve të regjistruar në këto degë. Drejtoria Arsimore Rajonale dhe Zyra Arsimore menjëherë, me mbarimin e regjistrimit në këto degë, dërgojnë informacion, në MASH, për numrin e nxënësve të regjistruar në këto degë.

6. Bursat e nxënësve, për vitet e dyta e lart, rishqyrtohen dhe miratohen, çdo vit, nga këshilli i bashkisë dhe i komunës, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktore.

Nxënësit që vitin e parë kanë përfitur bursë, me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës ku ata kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

7. Bursat e studentëve, për vitet e dyta e lart, rishqyrtohen dhe miratohen, çdo vit, nga institucionet e arsimit të lartë. Studentët e viteve të dyta e lart, që nuk kanë përfitur bursë dhe plotësojnë kriterin ekonomik, mund të përfitojnë bursë brenda numrit të planit të bursave, të përcaktuara sipas këtij vendimi.

Numri i bursave për këtë kategori studentësh dhe për studentët që përfitojnë bursë sipas pikës 2.2 është deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) në shkallë vendi, brenda numrit të përgjithshëm të bursave të dhëna për vitin 2010-2011. Institucionet e arsimit të lartë paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, kërkesat për studentët që përfitojnë bursë sipas pikës 2.2 të këtij vendimi “sipas rezultateve të arritura”.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes dhe e dërgon për ekzekutim në institucionet e arsimit të lartë. Studentët që vitin e parë kanë përfitur bursë, me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës ku kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

8. Nga plani i bursave të miratuara për vitin shkollor 2010-2011, bashkisë së Tiranës i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) bursa për studentët që vijnë nga familjet/shtresat sociale në nevojë dhe janë invalidë, paraplegjikë e tetraplegjikë, pavarësisht nga kriteri i studimit larg vendbanimit, ndërsa bashkive të tjera, të cilat në vendndodhjen e tyre territoriale kanë institucione të arsimit të lartë publik, u jepen deri në 5 (pesë) bursa, për këtë kategori studentësh.

9. Nxënësit dhe studentët që kanë përfitur statusin e jetimit, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përfitojnë falas veshmbathje, libra, fletore etj., sipas pasqyrës nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përjashtohen nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme, që ofrojnë shkollat.

9.1 Nxënësve dhe studentëve që kanë përfitur statusin e jetimit, u sigurohen falas, nga fondet e shkollave përkatëse, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet, pas paraqitjes së librezës dhe të kartës shëndetësore, si dhe të epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

9.2 Nxënësit jetimë e përfitojnë bursën edhe gjatë pushimeve verore, si dhe vetëm një vit kur humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluase.

9.3 Fëmijët dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti me një vakt ushqim (drekë), me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë.

10. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për studentët administrohen nga institucionet e arsimit të lartë. Bursat paguhen çdo muaj me kalim në numrin e llogarisë bankare të çdo studenti.

10.1 Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga bashkia e komuna, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktorë. Bursa u jepet nxënësve me ushqim në konvikt.

10.2 Nxënësve, të cilët nuk janë vendosur/akomoduar në konvikt, për mungesë kapacitetesh, bursa u paguhet çdo muaj nga bashkia/komuna, në llogarinë bankare të nxënësit/prindit përfitues, pranë bankave të nivelit të dytë apo në zyrat e Postës Shqiptare. Drejtorët e shkollave profesionale e socialkulturore dërgojnë, çdo muaj, pranë njësive të pushtetit vendor, frekuentimin e shkollës për nxënësit që përfitojnë bursë.

11. Niveli i bursës, për nxënësit dhe studentët, jepet sipas pasqyrave nr.2 e nr.3 dhe kuota financiare ushqimore ditore jepet sipas pasqyrave nr.4 e nr.5, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Drejtuesit e fakulteteve dërgojnë zyrtarisht, çdo muaj, pranë njësive/departamentit të financës, frekuentimin e shkollës për studentët që përfitojnë bursë.

12. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për vitin e ri shkollor 2010-2011, të japë 1950 (një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) bursa për nxënësit dhe 1600 (një mijë e gjashtëqind) bursa për studentët, për hyrjet e reja në vitin e parë në sistemin arsimor publik, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.



13. Efektet financiare të vitit shkollor 2010-2011 të përballohen nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës për vitin 2010, për pjesën e vitit 2010, si dhe nga Buxheti i Shtetit që do të miratohet për vitin 2011, për pjesën e vitit 2011.

14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave, për vitet e para, është data 15 dhjetor 2010, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa për vitet e dyta e lart është data 15 nëntor 2010.

15. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, për raste të veçanta, kur vendimet e këshillave të njësive të pushtetit vendor dërgohen jashtë afatit të përcaktuar në këtë vendim, ka të drejtë të shqyrtojë dhe të rivendosë në afat përfitimin e bursës për nxënësin/studentin.

16. Vendimet e njësive të pushtetit vendor dhe ato të institucioneve të arsimit të lartë publikohen për komunitetin, median dhe institucionet e tjera vendore apo qendrore.

17. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR/ZA-të, institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Pasqyra nr.1

**KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT DHE STUDENTIT PËR DHËNIEN E BURSËS (VITI MËSIMOR 2010-2011)**

<b>Nr.</b>	<b>Përbërja familjare</b>	<b>Përfitojnë bursa</b>	<b>Përfitojnë gjysmë bursa</b>	<b>Me pagesë</b>
	<b>Për qytetin</b>	<b>Me të ardhura mujore lekë/frymë</b>	<b>Me të ardhura mujore lekë/frymë</b>	<b>Me të ardhura mujore lekë/frymë</b>
1	Për familjet me 2 persona	Deri 3200	3200-4600	Mbi 4600
2	Për familjet me 3 persona	Deri 3100	3100-4500	Mbi 4500
3	Për familjet me 4 persona	Deri 3000	3000-4400	Mbi 4400
4	Për familjet me 5 persona	Deri 2900	2900-4300	Mbi 4300
5	Për familjet me 6 persona	Deri 2800	2800-4200	Mbi 4200
6	Për familjet me 7 persona	Deri 2700	2700-4100	Mbi 4100
7	Për familjet me 8 persona	Deri 2600	2600-4000	Mbi 4000

Shënim. Nxënësit dhe studentët nga fshati përfitojnë bursë, kur familja përfiton ndihmë ekonomike, në varësi të masës së kësaj ndihme, brenda planit të akorduar për secilën njësi të pushtetit vendor.

## NIVELI I BURSËS PËR NXËNËSIT (VITI MËSIMOR 2010-2011)

Në lekë

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës			Financimi nga nxënësi	Financimi nga shteti
		Për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës		
1	<b>Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme</b>					
	a) Bursa	5,963	200	6,163	0	6,163
	b) Gjysmë bursa	5,963	200	6,163	3,082	3,082
	c) Me pagesë	5,963	200	6,163	6,163	0
2	<b>Shkolla e Mjeshtrisë Sportive dhe Arsimit Special</b>					
	a) Bursa	6,463	200	6,663	0	6,663
	b) Gjysmë bursa	6,463	200	6,663	3,332	3,332
	c) Me pagesë	6,463	200	6,663	6,663	0
3	Nxënësit jetimë	6,463	200	6,663	0	6,663

## NIVELI I BURSËS PËR STUDENTËT (VITI MËSIMOR 2010-2011)

Në lekë

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës			Financimi nga nxënësi	Financimi nga shteti
		Për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës		
1	Universitetet, Akademia e Arteve dhe shkollat e tjera të larta					
	a) Bursa	6670	2000	8670	0	8670
	b) Gjysmë bursa	6670	2000	8670	4335	4335
	c) Me pagesë	6670	2000	8670	8670	0
2	Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve					
	a) Bursa	7170	2000	9170	0	9170
	b) Gjysmë bursa	7170	2000	9170	4585	4585
	c) Me pagesë	7170	2000	9170	9170	0

**KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE  
(VITI MËSIMOR 2010-2011)**

<b>Nr.</b>	<b>EMËRTIMI</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>Norma ditore</b>	<b>Vlera energjetike (në kcal)</b>	<b>Çmimi mesatar</b>	<b>Vlera ditore</b>
1	Bukë	gram	400	1117	83	33
2	Makarona	“	30	107	51	2
3	Oriz	“	30	109	82	2
4	Sheqer	“	40	157	78	3
5	Fasule	“	30	93	184	6
6	Perime	“	130	27	120	16
7	Fruta	“	100	42	108	11
8	Vaj	“	30	270	234	7
9	Gjalpë	“	20	152	531	11
10	Mish	“	90	130	620	56
11	Djath	“	25	40	352	9
12	Reçel	“	20	93	332	7
13	Vezë	kokërr	1	42	12	0
14	Qumësht	gram	200	98	40	8
15	Patate	“	200	170	85	17
16	Nënprodukte mishi	“	30	100	413	12
	<b>Kuota ditore</b>			<b>2746</b>		<b>199</b>

Shënim. Çmimi mesatar është indeksuar me normën mesatare të inflacionit, viti 2009.

Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas menuve të ndryshme, sipas çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

**KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E STUDENTËVE  
(VITI MËSIMOR 2010-2011)**

<b>Nr.</b>	<b>EMËRTIMI</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>Norma ditore</b>	<b>Vlera energjetike (në kcal)</b>	<b>Çmimi mesatar</b>	<b>Vlera ditore</b>
1	Bukë	gram	400	1117	83	33
2	Makarona	“	30	107	51	2
3	Oriz	“	40	145	82	3
4	Sheqer	“	40	157	78	3
5	Fasule	“	40	124	184	7
6	Perime	“	130	27	120	16
7	Fruta	“	100	42	108	11
8	Vaj	“	40	360	234	9
9	Gjalpë	“	20	152	531	11

10	Mish	“	98	140	620	61
11	Djath	“	42	66	352	15
12	Reçel	“	44	190	332	15
13	Patate	“	200	170	85	17
14	Qumësht	“	200	98	40	8
15	Vezë	kokërr	1	42	12	0
16	Nënprodukte mishi	gram	30	100	413	12
	<b>Kuota ditore</b>			<b>3037</b>		<b>222</b>

Pasqyra nr.6

#### KUOTAT FINANCIARE TË VESHMBATHJES (VITI MËSIMOR 2010-2011)

Nr.	Emërtimi	Kuota financiare në lekë e veshmbathjes për një vit kalendarik
1	Për fëmijët e arsimit special	7000 (shtatë mijë) lekë
2	Për jetimët	10 000 (dhjetë mijë) lekë

### KËRKESË

Nr.2727/6, datë 29.9.2010

#### PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe kulturave bujqësore, që preken nga ndërtimi i centralit elektrik me erë (parqe eolike).

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., Tiranë. Me anën të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË  
DHE ENERGJETIKËS  
**Ilir Meta**

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDRITIMIT TE CENTRALIT ELEKTRIK ME ERE (PARQE EOLIKE)**

**Qarku VLORE**

Lloji i pasurisë që shpronësohet: tokë bujqësore

Lloji i pasurisë që dëmtohet për shkak të ndërtimit: kultura bujqësore, të mbjella

Nr.	Objekti	Shpronësim definitiv										Shpronësim provizor					Vlera totale (Lekë)	Adresa e pronarit	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. I pasurisë	Sip. e pasurisë (m <sup>2</sup> )	Sip. shpronësim definitiv (m <sup>2</sup> )	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlera e kompensimit (Lekë)	Sasia në m <sup>2</sup>	Lloji i kulturës	Vlera Lekë/kg	Sasia (Kg/kg)	Vlera e kompensimit (lekë)			
1	Shylla e tensionit të lartë	Kujtim	Muharrem	Malaj	ullishte	2074	152/6	9000	50.00	430	21,500.00	50.00	ullishte	200	10000	31,500.00	Kanine	I pamundur përfundimi i procedurës së caktimit të kujdestarisë, pasi familja jeton jashtë shtetit dhe pronari është i paafat për të vepruar	
2	Shylla e tensionit të lartë	Budin	Muharrem	Luzi	ullishte	8601	55	18300	50.00	1061	53,050.00	50.00	e pambjellë	1	50	53,100.00	Vlorë	Ka pretendime mbi pronësinë nga të tretë, dhe është në vijim një proces gjyqësor për këtë çështje	
3	Shylla e tensionit të lartë	Hasko	Memo	Koçi	tokë arë	1569	593/11	9500	50.00	198.8	9,940.00	50.00	e pambjellë	1	50	9,990.00	Dukat	Nuk disponon AMTP, dhe një kopje e tillë nuk gjendet as në arkivin e ZRPP Vlorë	
4	Shylla e tensionit të lartë	Kosta	Allan	Gjitoka	tokë arë	1569	52/12	6800	50.00	190.5	9,525.00	50.00	e pambjellë	1	50	9,575.00	Tragjas	Nuk pranon të bashkëpunojë	
5	Shylla e tensionit të lartë	Haki	Mezin	Ramohitoj	tokë arë	3621	47/5	15000	50.00	190.5	9,525.00	50.00	e pambjellë	1	50	9,575.00	Tragjas	E pamundur të riset procedura e cejes se trashëgimisë, pasi trashëgimtari është i paafat fizikisht dhe nuk pranon të bashkëpunojë	

**Shuma në m<sup>2</sup>**

**250.00**

**Shuma në lekë**

**113,740.00**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-eksponitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE .....	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË .....	512 lekë

Hyri në shtyp më 11.10.2010

Doli nga shtypi më 13.10.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë